

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5759
E martë, 23 prill 2019
çmimi 0.40 €

Votat e shqiptarëve përcaktojnë presidentin e ri të Maqedonisë së Veriut



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



21 VJET NGA RËNIA E KOLOSIT TË UÇK-së, VELI NOCAJ F. 6

Erald SELCA

LIDERËT BËJNË THIRRJE QË TË RUHET AMBIENTI NË KOSOVË F. 7

DISA GRA TË KTHYERA NGA SIRIA PO HETOHEN PËR PJESËMARRJE NË GRUPE TERRORISTE F. 11



EKONOMI

PO I VJEN FUNDI KARTËMONEDHËS 500 EURO F. 8

GJERMANËT SHPENZUAN 8 MILIARDË EURO PËR BIRRA VITIN E KALUAR F. 9

SPORT

KLUBI I KARATESË 'PRISHTINA', I SUKSESSHËM EDHE NË TURNEUN 'SHPRESAT E KOSOVËS 2019' F. 19

FLET PËR "EPOKËN E RE", VIGAN QORROLI F. 4-5

Kosova në Samitin e Berlinit duhet të flasë me një zë

Njohësi i integriteteve evropiane, Vigan Qorrolli, ka thënë se presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj duhet të flasin me një zë në Samitin e Berlinit i cili do të mbahet më 29 prill. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo do ta forconte pozicionin shtetëror të Kosovës në raport me Serbinë. Qorrolli ka treguar se Samiti i Berlinit do t'i japë një përgjigje çështjes së shkëmbimit të territoreve dhe do t'i kornizojë në masë të madhe negociatat Kosovë - Serbi. Sipas tij, Samiti i Berlinit do të japë lajme të mira edhe për çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën



Shkrirja e KPMM-së në Shërbimin Gjeologjik dekurajon investitorët e huaj

Anëtari i Bordit në Komisionin e Pavarur për Minerale dhe Minerale (KPMM), Azem Rexhaj, i cili ka qenë edhe drejtor i këtij institucioni, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shkrirja e KPMM-së në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës do t'i dekurajojë investitorët e huaj për sektorin mineral. Ai ka bërë me dije se janë në përgatitje të një dokumenti nëpërmjet të cilit do ta arsyetojnë domosdoshmërinë dhe rëndësinë e KPMM-së në nivelin e agjencisë së pavarur. Rexhaj ka thënë



se këtë dokument do t'ia përcjellin qeverisë dhe do të jepen arsyet pse nuk duhet të dëmtohet ky sektor kaq i rëndësishëm F. 8-9



Vrasje e trefishtë në një familje në kryeqytet

F. 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Opozita ndryshon strategji, nga protestë në bllokim rrugësh!



Tiranë, 22 prill - Dy muaj nga nisja e protestave, opozita vendos të ndryshojë strategji. Në mbledhjen që lideri demokrat Lulzim Basha pati me krerët e degëve u ra dakord që të enjten të mos ketë protestë para Parlamentit, por aksioni të zhvendoset në rrugë me bllokimin e disa

akseve kryesore kombëtare. Burime i thanë "Top Channel" se, bllokimi i rrugëve nuk do të ndodhë në të njëjtën orë kur mazhoranca të mbledhet në seancë plenare, por pasdite. Përshkallëzimi i aksionit opozitar, me protesta rajonale në akset kryesore, i paraprin

protestës së katërt kombëtare para Kryeministrit, e cila do të mbahet të shtunën e 11 majit në orën 18:30.

Me krerët e degëve, Lulzim Basha diskutoi edhe për disa nga opsionet se si mund të pamundësohen zgjedhjet lokale, nëse ato do të mbahen pa opozitën.

Bushati: Nuk duhet sulmuar Holandën si vend racist

Ish-ministri i Jashtëm shqiptar dhe deputeti i PS-së, Ditmir Bushati në lidhje me qëndrimin e Holandës për vizat, ka thënë se do të ishte gabim fatal që ta vizatonim Holandën, anëtare themeluese e kontribuuese kyçe në BE, mbështetëse e aspiratës evropiane të Shqipërisë, si një vend racist ndaj nesh apo si një vend ku gëlon krimi e prostitucioni



TIRANË, 22 PRILL - Ish-ministri i Jashtëm dhe deputeti i PS-së, Ditmir Bushati deklaroi të dielën se nuk ka vend për panik për vendimin e Holandës në lidhje me qëndrimin e saj për vizat.

Bushati shpjegon se vendimi i Parlamentit holandez që i kërkon qeverisë nisjen e procedurave në nivel evropian për pezullimin e regjimit pa viza me Shqipërinë është padyshim një lajm i hidhur dhe mekanizmi i përcaktuar, në rast se aktivizohet nga Holanda, është i qartë.

"Komisioni Evropian do t'i përgjigjet kërkesës (së supozuar deri tani) të Holandës mbi kriteret e përmbushura nga ana e Shqipërisë dhe çdo vendimarrje kërkon një shumicë të caktuar votash në Këshill, ku pesha e votave të vendeve anëtare është e ndryshme", sqaron ai.

Po ashtu, Bushati thekson se vitin e kaluar, raporti i Komisionit Evropian për këtë çështje vlerëson se Shqipëria i përmbushte kriteret.

"Vlen të theksohet gjithashtu se asnjë prej vendeve anëtare të BE-së, përfshirë Holandën, nuk kundërshtoi gjetjet e Komisionit.

Në të tilla rrethana me të drejtë lind pyetja çfarë ndryshoi në pak muaj nga publikimi i raportit të Komisionit Evropian vitin e kaluar? Pse një lëvizje e tillë tani kur Shqipëria pret zyrarizimin e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, bazuar në kalendarin e miratuar në qershorin e 2018 nga vendet anëtare të BE-së dhe procesin analitik screening?", tha ai.

Më tej Bushati shton se shanset që një nismë e tillë të prodhojë efekte në praktikë janë thuajse zero.

"Ndaj nuk ka vend për panik. Shqipëria edhe pse ka shumë sfida në betejën me krimin e organizuar dhe korrupsionin i përmbush kriteret e përcaktuara sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian. Megjithatë, nuk ka vend për neglizhencë e aq më keq për stigmatizim. Përkundrazi duhet të sigurojmë integritetin e debatit publik në lidhje me këtë çështje. Jemi në të drejtën tonë të përbuzim çdo stereotip negativ që tenton të na vizatojë si njerëz e shoqëri që prodhojmë veç krim dhe emigracion të paligjshëm. Por do të ishte gabim fatal që ta

vizatonim Holandën, anëtare themeluese e kontribuuese kyçe në BE, mbështetëse e aspiratës evropiane të Shqipërisë, si një vend racist ndaj nesh apo si një vend ku gëlon krimi e prostitucioni. Do të ishte mendjelehtësi gjithashtu të injoronim mesazhin që vjen prej kësaj nisme të Parlamentit holandez, edhe pse e padrejtë dhe në mungesë të kriterëve të përcaktuara nga vetë BE-ja", thekson ai.

Në vijim të argumentimit të tij Bushati shpreh se "të drejtën tonë duhet të vazhdojmë ta demonstrojmë me vendosmëri përmes rezultateve të prekshme në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit. Duke shtuar angazhimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar me organet e specializuara, me Komisionin Evropian dhe me

vendet anëtare të BE-së. Sepse në asnjë rast nuk duhet të harrojmë që jemi ne që po trokasim në dyert gjithnjë e më vështirë të penetrueshme të BE-së dhe jo e kundërta. Vendimi i Parlamentit holandez, edhe pse i pari për një nga shtetet që janë pjesë e listës së bardhë të Schengen, nuk është rrufe në qiell të kaltër. Vjet, në vigjilje të vendimit të BE-së për nisjen e bisedimeve për anëtarësim, Parlamenti holandez, përmes një rezolutive, i kërkoi qeverisë bllokimin e bisedimeve me Shqipërinë. Është fakt tanimë i njohur se për shkak të kundërshtisë së Francës dhe Holandës, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nuk i nisën menjëherë bisedimet për anëtarësim në BE. Kjo situatë shtyu vendet anëtare drejt një formule kompromisi me kalendar të përcaktuar për nisjen

e këtij procesi pas qershorit të 2019".

"Në vitin 2016 Holanda ishte vendi i vetëm në BE që organizoi referendum për marrëveshjen ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ukrainës edhe pse u kritikua gjerësisht për pandershmëri dhe mungesë vizioni strategjik, duke pasur parasysh situatën specifike me të cilën përballej Ukraina pas aneksimit të Krimesë nga ana e Rusisë dhe nevojën dramatike që kishte BE-ja për t'u pozicionuar si lojtar i besueshëm në raport me ambicien e Ukrainës për t'u afruar drejt BE-së. Si rrjedhojë e këtij referendumi, marrëveshja BE-Ukrainë përmban garanci shtesë për tu mos interpretuar në asnjë rrethanë si marrëveshje që shtron rrugën e anëtarësimit të Ukrainës në Bashkimin Evropian", tha Bushati.

Astrit Patozi, kryetar i partisë "Bindja Demokratike"

TIRANË, 22 PRILL - Forca më e re politike, "Bindja Demokratike", ka siguruar 3000 firma për t'u regjistruar në Gjykatën e Tiranës. Procedura ligjore pritet të formalizohet sot (e martë), që përkon edhe me afatin e fundit të regjistrimit të partive politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për garën elektorale të 30 qershorit. Partia e re nuk e ka zyrarizuar ende kryetarin e

saj. Por ajo do të drejtohet nga ish-nënkryetari i Partisë Demokratike, Astrit Patozi. Rudina Hajdari, që mendohej se do të ishte pjesë e kësaj partie politike, mësohet se është tërhequr përkohësisht nga ky projekt. Deputetja që kryeson grupin e ri demokrat në parlament pati një takim me Patozin të shtunën për të diskutuar mbi detajet e grupimit të ri politik, por

burimet thonë se në momentin final, ajo ka hezituuar për të qenë në krye të partisë dhe ka kërkuar më tepër kohë. Këtë qëndrim, deputetja Hajdari e ka përforcuar përmes një statusi në rrjetet sociale, ku pohon se nuk do të jetë në krye të kësaj partie dhe se angazhimi kryesor për të është kryesimi i grupit parlamentar demokrat në parlament.



Më 5 maj do të mbahet raundi i dytë i zgjedhjeve për president të Maqedonisë së Veriut

Votat e shqiptarëve përcaktojnë presidentin e ri të Maqedonisë së Veriut



Raundi i dytë i zgjedhjeve për president të Maqedonisë së Veriut do të mbahet më 5 maj meqenëse asnjëri prej tre kandidatëve nuk ka arritur t'i marrë 51 për qind të votave në zgjedhjet e së dielës. Sipas të dhënave paraprake të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Stevo Pendarovski ka fituar 42.72 për qind, Gordana Siljanovska - Davkova 42.58 për qind dhe Blerim Reka 10.35 për qind. Votat e shqiptarëve do ta përcaktojnë fituesin e balotazhit, prandaj dy kandidatët që kanë mbetur në garë qysh tani kanë filluar përpjekjet për t'i rrëmbyer këto vota. Kandidati i koalicionit qeverisës, Stevo Pendarovski, u ka bërë thirrje votuesve të Blerim Rekës që ta mbështesin më 5 maj

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 PRILL - Meqenëse asnjëri prej kandidatëve nuk ka arritur t'i fitojë votat e mjaftueshme për t'u bërë president i Maqedonisë së Veriut, më 5 maj do të mbahet edhe raundi i dytë i zgjedhjeve. Në garën e balotazhit do ta vazhdojnë betejën kandidatit i pozitës Stevo Pendarovski, që ka fituar 42.72 për qind, dhe kandidatja e opozitës, Gordana Siljanovska- Davkova, që ka fituar 42.58 për qind. Kurse kandidatit shqiptar i cili ka garuar si i pavarur, Blerim Reka, ka fituar 10.35 për qind. Sipas këtij rezultati, votat e shqiptarëve do ta përcaktojnë fituesin e balotazhit, prandaj dy kandidatët që kanë mbetur në garë tashmë kanë filluar përp-

jekjet për t'i rrëmbyer këto vota.

Kandidati i mbështetur nga partitë politike në pushtet, Stevo Pendarovski, në një adresim për media ka thënë se është i kënaqur që shumica e qytetarëve në Maqedoninë e Veriut kanë votuar për të. Pendarovski u ka bërë thirrje votuesve të kandidatit shqiptar, Blerim Reka që ta mbështesin me votë më 5 maj, në raundin e dytë të zgjedhjeve. "Unë e di se ju e mbështesni vizionin tim për Maqedoninë evropiane dhe të integruar. Më maj 5 kemi nevojë për pjesëmarrje maksimale në zgjedhje dhe mbështetje për konceptin që çon këtë vend përpara", ka deklaruar Pendarovski në konferencën për media.

Edhe kryeministri dhe kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev, ka thënë

se në zgjedhjet e së dielës ka fituar koncepti që çon para vendin, ndërsa ka ftuar qytetarët që në balotazh ta vulosin fitoren e kandidatit pro evropian, Stevo Pendarovski. Kryeministri Zaev ka thënë se në balotazh pret mbështetjen e qytetarëve që votuan për Blerim Rekën. "Jam i bindur se në rrethin e dytë do të arrijmë edhe një vlerë evropiane, do të kemi president evropian për shtetin tonë. Pendarovski po udhëheq në zgjedhje fer dhe demokratike. Në këto zgjedhje do të vendoset se a do të ecim përpara apo do të kthehemi në izolim. Në rrethin e dytë kemi dy koncepte, të bashkimit dhe ecjes përpara, dhe konceptin e Siljanovskës, të ndarjes dhe kthimit pas. Është e qartë se në rrethin e dytë koncepti i

Pendarovskit do të ketë mbështetje edhe më të madhe. Pres që edhe qytetarët që votuan për Blerim Rekën të na bashkohen në rrugën që çon para shtetin", ka deklaruar Zaev.

Edhe kryetari i VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickovski, u ka bërë thirrje qytetarëve që në balotazh ta votojnë kandidatën e opozitës, Gordana Siljanovska-Davkova. Ai ka theksuar se fitorja e së dielës e kandidatës opozitare është edhe një dëshmi se populli nuk pajtohet me politikën e dështuar dhe të dëmshme të qeverisë aktuale. "Kjo fitore është e madhe, është fitore e popullit. Maqedonia ka një realitet të ri. Ajo është krenare pasi fitoi drejtësinë, fitoi koalicioni i VMRO-së me popullin.

Mundem LSDM-së dhe shumë parti të tjera që, për fat të keq, vendosën që të jenë shërbëtoresh të Zoran Zaevit. Pushteti është në apati. Pranvera demokratike po vjen, po fillon realiteti i ri në atdhe. Do të jemi së bashku deri në fitoren e madhe", ka deklaruar Mickovski.

Gazeta ka kontaktuar kandidatit shqiptar për president, profesorin Blerim Reka, për të marrë përgjigje se cilin nga kandidatët do ta përkrahë në raundin e dytë të zgjedhjeve, por ai nuk ka dashur të deklarohet për këtë çështje. "Kam vendosur një herë të mos jap deklarata për media", ka thënë Reka.

Një ditë më parë Reka është shprehur i kënaqur nga rrjedha e votimit dhe rezultati i arritur. "Në të gjitha komunat shqiptare udhëheqin 3 me 1 në raport me kandidatët e tjerë. Koncepti ynë 'Republika për të gjithë' ka marrë mbështetje edhe në ato komuna ku nuk kemi shtrirje partiake. Kjo jep shpresë se Maqedonia do të jetë shtet i të gjithëve. Me votat e siguruar ne kemi deligitimuar partitë e tjera shqiptare dhe kjo paralajmëron një pranverë politike", ka deklaruar Reka.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KShZ) ka bërë me dije se procesi zgjedhor i së dielës është zhvilluar kryesisht në atmosferë të qetë dhe demokratike. Në zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut kanë votuar 42.03 për qind nga rreth 1.8 milion qytetarë me të drejtë vote.



Flet për "Epokën e re", Vigan Qorrolli

Kosova në Samitin e Berlin

Njohësi i integritimeve evropiane, Vigan Qorrolli, ka thënë se presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj duhet të flasin me një zë në Samitin e Berlinit i cili do të mbahet më 29 prill. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo do ta forconte pozicionin shtetëror të Kosovës në raport me Serbinë. Qorrolli ka treguar se Samiti i Berlinit do t'i japë një përgjigje çështjes së shkëmbimit të territoreve dhe do t'i kornizojë në masë të madhe negociatat Kosovë - Serbi. Sipas tij, Samiti i Berlinit do të japë lajme të mira edhe për çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 22 PRILL -

"Epoka e re": Z. Qorrolli, janë bërë gjashtë vjet nga nënshkrimi i marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Këtë proces deri më tani e kanë përcjellë problematika të shumta. Si do ta vlerësoni në përgjithësi dialogun e deritashëm të Brukselit?

Qorrolli: Gjashtë vjet të negociatave janë gjashtë vjet tejet problematike në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pothuajse fare nuk ka ndryshuar gjendja faktike dhe që të dy shtetet janë larg normalizimit mes vete. Shumë marrëveshje janë arritur, por shumë pak janë implementuar. Dialogu që në fillim është konceptuar sipas modelit "më mirë negociata se luftë", prandaj edhe ulja në një tavolinë mes shqiptarëve dhe serbëve është konsideruar si një lloj triumfi nga ana e BE-së, ndërsa kjo ka ardhur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe "traumave" që i ka përjetuar Serbia në periudhën e post 17 shkurtit 2008. Bashkimi Evropian, duke qenë se nuk është unik në politikën e jashtme, e ka arritur vetëm një rezultat në këtë proces. Ai është ulja në bisedime mes palëve. Asnjë garanci tjetër nuk është dhënë për palët rreth zbatimit të marrëveshjeve dhe një strategjie për arritjen e paqes finale mes dy kombeve. Në mungesë të kësaj strategjie, Kosova dhe Serbia janë krekosur para publikut të tyre të brendshëm, se janë të gatshme për negociata dhe dialogu do t'i sjellë frytet më të mira për ta: për Kosovën do ta sjellë njohjen nga Serbia dhe ulësen në OKB, ndërsa për Serbinë ndarjen e Kosovës në vija etnike dhe anëtarësimin e saj në BE. Që të dyja shtetet me

një fjalë janë treguar thellësisht të pasinqerta me publikun e tyre sepse, siç po vërehet gjashtë vjet më pas, arritja e një paqeje përfundimtare midis dy shteteve është ende larg. Së dyti, vetë dialogu nuk ka pasur një strategji konkrete në bazë të të cilës do të arriheshin disa rezultate të prekshme dhe jo synime për rezultate të tilla utopike siç pretendojnë palët. Rezultat i prekshëm do të ishte përmirësimi i jetës së qytetareve brenda territoreve të tyre, zbatimi i marrëveshjes për lëvizje të lirë dhe respektimi ekonomiko-politik i ndërsjellë. Asnjëri prej këtyre tre faktorëve nuk është respektuar. Përkundrazi, Serbia është treguar tejet destruktive në raport me Kosovën në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke lobuar kundër njohjeve të saj, madje duke i paraqitur si suksese të saj disa "çnjohje", kryesisht nga vendet e botës së tretë. Së treti, dialogu asnjëherë nuk është afatizuar sepse, duke mos qenë i tillë, ai nuk mund të vazhdojë pafundësisht. Bashkimi Evropian si ndërm-

jetës nuk ka vendosur afat kohor se kur duhet të përfundojë ky dialog, por për këtë as palët në bisedime asnjëherë nuk kanë qenë të gatshme. Pra, do të duhej të kishte një pajtim paraprak për prioritetet dhe afate, gjë që me këtë format aktual ky dialog nuk i ka asnjëherë. Afatizimi i dialogut është çelësi i suksesit të tij. Prandaj, dialogu ka "vdekur klinikisht" dhe, si i tillë, është i pasuksesshëm sepse nuk e ka arritur empirikisht asnjë rezultat konkret, të cilin në fillim e ka synuar. Shtetet nuk i kanë normalizuar raportet mes tyre, dy popujt janë larg pajtimit historik dhe, në mungesë të këtyre dy rezultateve të synuara, ka lindur ideja tejet e rrezikshme për shkëmbim territorësh si epilogu i fundit eventual për normalizim.

"Epoka e re": Prej verës së vitit të kaluar është folur shumë për fazën finale të dialogut. Gjatë kësaj kohe ka pasur reagime vendore dhe ndërkombëtare rreth idesë së korrigjimit të kufijve, miratim të delegacionit

shtetëror dhe platformës, si dhe vendosjes së taksës ndaj produkteve serbe. Së fundi, disi janë heshtur këto debate. Pse mendoni se ka ndodhur kjo?

Qorrolli: Kjo që po ndodh është më tepër si pasojë e mungesës së konsensusit ndërmjet spektrit politik kosovar. Shumë ide, shumë polemika, shumë strategji, por mungesë totale e një përgjegjësie shtetërore të partive politike parlamentare. Mungesa e konsensusit prodhon revanshizëm dhe kundërgoditje, prandaj duhet vendosur një konsensus moral midis grupeve të ndryshme politike në Kosovë, i cili do t'i detyronte politikanët tanë për një rivlerësim të shqetësimeve dhe prioritetëve të shoqërisë. Në veçanti, shoqëria jonë kërkon që të hiqet një herë e mirë nga "menyja ditore" çështja e dialogut me Serbinë. Cili do që të jetë rezultati, shoqëria jonë ka nevojë për përfundimin e këtij trileri politik. Dhe kjo gjë duhet të arrihet përmes konsensusit, përndryshe një vazhdim i tillë i egër i luftës ditore nga një

ekstrem politik në tjetrin, do të prodhojë ngjarje të tmerrshme për jetën e kosovarëve. Vendosja e taksës nga kryeministri Haradinaj është bërë me qëllim që të parandalohet fushata agresive për ndarjen e Kosovës, të cilën dy presidentët, Thaçi dhe Vuçiq, e kanë në kokë që një kohë të gjatë. Problemi fundamental nuk është vetëm ndarja, është mungesa e ideve kreative për përmirësimin e jetës së qytetarëve në vend, prandaj në tranzicionin e stërzgatur të Kosovës partitë e përdorin inercionin brenda tyre si alibi për mosarritjen e rezultateve të prekshme për jetën e njeriut në baza ditore. Konsensusi gjithëpartiak nuk është vendosmërisht i njëjtë si "konsensusi për të qeverisur", prandaj ndonjëherë liderët tanë politikë thirren në legjitimitet për t'i justifikuar gabimet e tyre ditore. Delegacioni i votuar shtetëror në Kuvend, bashkë me platformën, por edhe taksa ndaj Serbisë, janë dokumente të cilat do te jetojnë për një afat të shkurtër. Shoqëria jonë kërkon konsen-



it duhet të flasë me një zë

konflikteve?" Kjo do të jetë pyetja kryesore, së cilës përgjigje do t'i japin liderët e vendeve të Ballkanit para dyshes Merkel - Macron. Gjermania nëpërmjet kancelares Merkel tash është pozicionuar haptazi kundër shkëmbimit dhe për këtë do ta bindë edhe presidentin francez, Macron, si bashkënikoqir i kësaj konference.

ShBA-ja ndodhet në një pikë më strategjike sepse e ka lënë të hapur çdo mundësi për të cilën merren vesh palët, por me gjasë do të pozicionohen kundër pas argumenteve të cilat do t'i prodhojë samiti i Berlinit. Gjermanët veçanërisht janë të bindur se nuk ka asnjë garanci që nëse preken kufijtë e Kosovës dhe Serbisë, kjo nuk do të ketë efekte anësore edhe për vendet e tjera të Ballkanit. Precedenti pozitiv i marrëveshjes në mes të Maqedonisë dhe Greqisë për emrin i ka luhatur vendet e BE-së që fillimisht mendonin se zgjidhja territoriale është zgjidhja më e mirë. Duhet thënë se koncepti i shkëmbimit fillimisht u mbështet nga shefja e politikës së jashtme e BE-së, Federica Mogherini, komisionari i BE-së, Johannes Hahn, këshilltari për siguri kombëtare i ShBA-së, John Bolton, nga Austria dhe Hungaria, ndërsa u kundërshtua qysh në fillim nga Gjermania. Po ashtu, ideja e shkëmbimit territorial ka krijuar frikë të fortë të zhvendosjes së popullsisë, veçanërisht për serbët në jug të Kosovës, që janë shumicë për dallim prej atyre në veri. Pyjet dhe livadhet ndoshta mund të shkëmben, por kjo për shekullin 21 do të thotë traumë për njerëzit që jetojnë brenda atyre territoreve. Siç e dimë, dy vendet, veriu i Kosovës dhe jugu i Serbisë, janë të populluara respektivisht dhe nuk janë toka të pabanuara. Sidoqoftë, në Berlin do të theksohet se është më e rëndësishme të "ketë një marrëveshje të mirë" mes Serbisë dhe Kosovës sesa një të shpejtë. Kjo është ajo që unë pres sepse në instancë të fundit qëllimi i marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë është t'i normalizojë marrëdhëniet mes dy vendeve vetëm në kontekstin e afrimit me BE-në.

"Epoka e re": Deri më tani nuk kemi parë ndonjë koordinim të presidentit dhe kryeministrit për këtë samit. Si do të duhej të paraqiten institucionet e Kosovës në këtë samit?

Qorrolli: Do të duhej të paraqiteshin me një zë të unifikuar se nuk ka ndarje të Kosovës dhe nuk ka shkëmbim territorial me Serbinë. Kjo do ta forconte pozicionin shtetëror të

Kosovës në raport me palën e kundërt (Serbinë). Në rast se ka diskrepanca dhe, siç po shihet, do të ketë, atëherë kjo gjë do ta vështirësojë pozicionin ndërkombëtar të Kosovës. Në nivelin e brendshëm, presidenti Thaçi dhe kryeministri Haradinaj kanë dallime të mëdha për çdo çështje, por kjo e samitit të Berlinit do të duhej t'i përfronte me idenë e ruajtjes së Kosovës së 17 shkurtit 2008. Problemi i tyre politik është shumë i rëndësishëm sepse është problem i autoritetit dhe i kontrollit. Që të dy përmes pushteteve të tyre synojnë autoritet dhe kontroll mbi insti-

tucionet e tjera kosovare. Përshtatja me demokracinë duhet t'i mësojë që të dy të sillen konform kriterëve dhe procedurave të saj dhe një prej kushteve esenciale të demokracisë është pajtimi dhe konsensusi.

"Epoka e re": Në bazë të rrethanave vendore dhe ndërkombëtare, sa janë gjasat që të kemi një marrëveshje përfundimtare gjatë këtij viti?

Qorrolli: Për këtë duhet pritur përfundimi i Samitit të Berlinit i cili do t'i kornizojë në masë të madhe këto negociata dhe një konferencë ndërkombëtare për Kosovën (sipas gjasave do të

mbahet në ShBA) pritet të ndodhë së shpejti, aty ku do të nënshkruhet "paqja e madhe mes dy shteteve". Në muajin maj do të mbahen zgjedhjet për institucionet e BE-së, ndërsa në vjeshtë është me realiste të presim për një afatizim më të saktë kohor se kur do të ndodhë kjo marrëveshje. Megjithatë, Samiti i Berlinit do të japë lajme të mira edhe për çështjen e vizave për Kosovën, pastaj për kandidaturat për BE të Shqipërisë dhe Maqedonisë si dhe një varg çështjesh të tjera ekonomike dhe politike për vendet ballkanike.

PDK-ja zgjedh kryetarët e degëve edhe në Skenderaj, Podujevë dhe Gjilan

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Dega e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Skenderaj ka mbajtur Kuvendin Zgjedhor të Degës në prani të delegatëve nga të gjitha nëndegët, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe anëtarit të kryesisë, Abelard Tahirit. Në Skenderaj, në emër të kryetarit ka folur anëtari i Kryesisë, Abelard Tahiri, për Dekadën e Re dhe vlerat e kësaj platforme. Ndërsa për fitoret dhe sukseset e Degës në Skenderaj ka folur kryetari Sami Lushtaku. Ndërsa në emër të Komisionit për Zgjedhje të Skenderajt ka folur kryetari i Komisionit, Fadil Nura, i cili ka thënë se mbi 10 000 vota kanë marrë pjesë në kuvendet e nëndegëve, në garë demokratike në të gjitha nëndegët. Këtë punë po e përfundojmë me këtë kuvend që është festiv dhe demokratik. Kryetar u zgjodh Sami

Lushtaku. Po ashtu, Kuvendi zgjodhi Këshillin Drejtues me 71 anëtarë dhe 28 delegatë për Konventën Qendrore. Po ashtu, në Podujevë është mbajtur Kuvendi Zgjedhor në frymë demokratike, në një garë fer dhe demokratike, garë e ngushtë në mes të dy kandidatëve, Naim Fetahut dhe Fahri Osmanit. Rezultati pas numërimit të votave ishte i ngushtë, 117 me 115, ku Fetahu u zgjodh kryetar dege i PDK-së në Podujevë. Në emër të Kryesisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve foli Fehmi Mujota, i cili ka theksuar se "PDK-ja po zhvillon një proces zgjedhor të paparë në Kosovë deri më sot, proces i cili po krijon frymën e re të Dekadës së Re që pashmangshëm do ta bëjë PDK-në forcën pa konkurrencë në Kosovë, me Kadri Veselin kryeministër të ardhshëm". Kuvendi zgjodhi edhe Këshillin

Drejtues dhe delegatët për Konventën Qendrore të partisë. Kuvendi Zgjedhor i Degës së PDK-së në Gjilan po ashtu u zhvillua me frymë demokratike dhe konform procedurave demokratike për procesin zgjedhor. Në emër të PDK-së nga qendra foli nënkryetari Uran Ismaili dhe Zenun Pajaziti, të cilët theksuan procesin dhe garën demokratike në Gjilan, në secilën nëndegë, me platformën Dekada e Re. Po ashtu, u theksua rëndësia e procesit zgjedhor për Dekadën e Re, e fuqizimit të shtetit dhe shtetësisë së Kosovës. Pas numërimit të votave, rezultatet për kandidatët ishin si vijon: Qemajl Mustafa, 197, Flurim Arifi me 80 vota, 7 vota ishin të pavlefshme. Po ashtu, Kuvendi Zgjedhor në Gjilan votoi për delegatët për Konventën Qendrore të partisë dhe anëtarët e Këshillit Drejtues.



sus për këtë temë dhe arritja e tij do ta delegitimojë edhe ndarjen, edhe Serbinë, si problemi më akut i vonësës në shtetndërtimin tonë.

"Epoka e re": Samiti i Berlinit pritet të mbahet në fund të këtij muaji. Cilat janë pritjet tuaja nga ky samit, ngaqë çdo ditë e më tepër po forcohet përshtypja se në këtë takim mund të prezantohet ndonjë plan për marrëveshjen Kosovë - Serbi?

Qorrolli: Tashmë kemi disa pozicione shumë të qarta të krerëve të diplomacisë botërore lidhur me shkëmbimin e territoreve ose jo mes Kosovës dhe Serbisë, si qëllim për ta arritur paqen finale. ShBA-ja dhe Gjermania janë zyrtarisht kundër një ideje të tillë. Mbledhja në Berlin e të gjithë liderëve të Ballkanit Perëndimor është bërë për ta sqaruar vetëm një çështje, që është e një karakteri empirik: "A është shkëmbimi territorial midis shteteve përgjatë vijave ndarëse etnike në shekullin e 21-të një mjet i përshtatshëm për zgjidhjen e

Qytetarëve të Kosovës në vendet e BE-së nuk u njihen patentshoferët

Mosnjohja ndërkombëtare e dokumenteve personale të Kosovës është bërë shqetësim i madh për shumë qytetarë të Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit

PRISHTINË, 22 PRILL - Osman Berisha nga qyteza e Malishevës në Kosovë, i cili që tre vjet jeton në Itali, thotë se nuk i njihet patentshoferi nga autoritetet italiane. "Problemi dhe shqetësimi i shumë qytetarëve që unë njoh e që jetojnë në Itali është mosnjohja e patentshoferit të Kosovës. Në shumicën e rasteve kur policia lokale na ndalon, na merr patentën dhe na dënojnë. Disa persona që unë njoh kanë marrë dënime nga policia italiane për shkak se, kur janë ndaluar, e kanë pasur patentshoferin e Kosovës", tregon Berisha.

Ai thotë se në të kaluarën ka pasur tolerime edhe nga policia lokale, por tani çdo person që ndalohet dhe ka patentën e Kosovës, ata menjëherë ia konfiskojnë. "Kam shoqëri këtu në Itali që janë nga Moldavia dhe Shqipëria e që atyre u njihet patentshoferi i vendit prej nga vijnë. Ata me patentshoferët që kanë marrë në vendin e vet mund të vozisin në Itali. Unë kam biseduar edhe me Ambasadën e Kosovës këtu në Itali. Ajo është në dijeni për këtë problem, por ka thënë nuk kemi çfarë të bëjmë. Nëse ajo nuk ka çfarë të bëjë, çfarë të bëjmë ne?!", ka thënë Berisha. Autoritetet në Kosovë thonë se që nga viti 2013 kanë filluar negociatat me disa nga vendet e Bashkimit Evropian që të arrijnë marrëveshje reciproke për njohje ndërkombëtare të

dokumenteve personale të Kosovës, konkretisht për njohje të patentshoferëve.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme i Qeverisë së Kosovës, Izmi Zeka, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se si me shtetet e tjera të BE-së, edhe me Italinë nuk kanë arritur të një marrëveshje përfundimtare për njohje të patentshoferëve. "Që nga viti 2013 kemi filluar të negociojmë me shtete të ndryshme, duke filluar me Austrinë, Italinë, Slloveninë, Kroacinë e të tjera, por nuk kemi arritur deri më tani ndonjë marrëveshje. Negociatat e fundit me autoritetet italiane kanë qenë në muajin gusht, por ende nuk kemi asgjë zyrtare për një marrëveshje reciproke për njohje të patentshoferëve", ka theksuar Zeka. Ai ka shtuar se si ministri i kanë bërë angazhimet e duhura për njohje të patentshoferëve dhe se nuk i dinë arsyet e shteteve për mosarritje përfundimtare të këtyre marrëveshjeve. "Ne si ministri kemi bërë krejt çfarë është e mundur që të arrijmë marrëveshje dhe jemi të vetëdijshëm për problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët tanë që jetojnë në këto shtete", ka theksuar Zeka.

Ministria e Punëve të Brendshme, në kuadër të përpjekjeve të saj për njohje ndërkombëtare të dokumenteve personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës, deri në tani ka nënshkruar marrëveshje



me Republikën e Shqipërisë dhe atë të Maqedonisë së Veriut. Në bazë të këtyre marrëveshjeve, palët kontraktuese njohin reciprokisht zëvendësimin, konvertimin e patentshoferëve/lejeve të drejtimit të vlefshme, të lëshuara nga autoritetet kompetente të palës tjetër kontraktuese, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, në favor të mbajtësve të patentshoferëve/lejeve të drejtimit, të cilët kanë fituar të drejtën e vendqëndrimit të ligjshëm - rezidencën normale në territorin e vendit të tyre. Në shkurt të këtij viti ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, pati dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme kërkesat për marrje të rekomandimit për miratim në

parim me shtetet e BE-së për njohje reciproke të patentshoferëve.

Ministri Mustafa kishte kërkuar që ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverive të Republikës Federale Gjermane, Konfederatës Helvetike, Republikës Franceze dhe Republikës së Malit të Zi, të fillohet nisma për njohje reciproke të patentshoferëve. "Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, por nuk ka arritur të marrë ndonjë përgjigje lidhur me këtë çështje. Të njëjtin problem me patentshofer e ka edhe Altin Kelmendi, i cili që nga viti 2007 jeton në Itali. "Ka shumë njerëz që vozisin me patentshofer të Kosovës këtu në Itali, por në

momentin që ndalohen nga policia italiane patenta iu sekuestrohet dhe dënimet shkojnë fillimisht 150 euro, por nëse lënda shkon në gjykatë, dënimi arrin deri në 9 000 euro. Ne nuk po kërkojmë të na njihet komplet patentshoferi i Kosovës, por të na mundësohet që të testohemi vetëm për vozitje e jo edhe teorikisht, pasi shumë shqiptarë të Kosovës këtu në Itali nuk e njohin mirë gjuhën për të arritur të pajisen me patentë të shtetit të Italisë", ka thënë Kelmendi.

Ministria e Punëve të Brendshme vitin e kaluar ka lansuar patentshoferin me dizajn të ri, i cili është i pajisur me teknologjinë e fundit për siguri të dokumenteve dhe në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian.

Ministri Bytyqi priti 120 nxënës nga Kosova dhe Shqipëria

Prishtinë, 22 prill (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur 120 nxënës nga Kosova dhe Shqipëria, të cilët janë të parët që kanë filluar programin e përbashkët për shkëmbimin e nxënësve mes dy vendeve.

Të 60 nxënësit kosovarë kanë qëndruar për një javë në Shqipëri, të shpërndarë nëpër familje, ku edhe kanë ndjekur mësimin në gjimnazet atje. Ndërsa 60 moshatarët e tyre, të ardhur bashkë me ta në Kosovë, do të qëndrojnë në familjet e këtyre nxënësve dhe, po ashtu, do ta ndjekin mësimin në gjimnazet në Kosovë.

Ministri Bytyqi, me këtë rast, ka uruar nxënësit që janë bërë pjesë e këtij programi të rëndësishëm që ka për qëllim krijimin dhe thellimin e miqësisë

mes të rinjve tanë. Ai u ka thënë nxënësve se tashmë e kanë përjetuar se ne jemi një komb.

Ministri ka theksuar se kjo është një mundësi e mirë që ata të njihen mes vete, pra të krijojnë dhe të thellojnë miqësi, e cila do t'i shërbejë të ardhmes së dy vendeve që kanë të njëjtën gjuhë, kulturë dhe traditë.

Ndërsa zëvendësministria e Arsimit e Shqipërisë ka theksuar edhe faktin se nxënësit kanë rastin të mësojnë se si funksionon sistemi i arsimit në Kosovë dhe Shqipëri.

Gjatë qëndrimit të Kosovë, nxënësit nga Shqipëria, bashkë me moshatarët e tyre, përveç mësimin, do të vizitojnë edhe vende kulturore dhe historike. Programi për shkëmbimin e nxënësve ka filluar me mar-



rëveshjen paraprake mes ministrit të Arsimit të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, Shyqiri Bytyqi dhe Besa Shahinit, dhe

do të vazhdojë me grupe të tjera të nxënësve.

Vizita e nxënësve nga Shqipëria do të përmbyllet me një cere-

moni në Prizren, ku do të marrin pjesë zyrtarë të lartë të shtetit dhe ministrat e arsimit të dy vendeve.

Vrasje e trefishtë në një familje në kryeqytet

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Të hënën rreth orës 15:20 në rrugën "Bill Clinton" në Prishtinë ka ndodhur një vrasje e trefishtë në një familje, ku një burrë ka vrarë bashkëshorten dhe gruan e djalit, më pas është vetëvrasur. Menjëherë për kësaj ngjarje prokurorët kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë nisur hetimet në lidhje me rastin. Në një konferencë për media nga vendi i ngjarjes ka folur zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Baki Kelani, i cili ka treguar për vrasjen tragjike.

Kelani ka thënë se viktimat janë: një grua e lindur më 1991, një tjetër grua e lindur më 1959 dhe një burrë i lindur më 1958.

"Policia e Kosovës ka pranuar informata se rreth orës 15:20 ka ndodhur një rast tragjik në lagjen 'Dardania' në rrugën 'Bill Clinton', ku fillimisht ka qenë informacioni për një vrasje të dyshimtë. Pastaj dyshohet të ketë ndodhur një vrasje dhe vetëvrasje. Policia e Kosovës me të pranuar informacionet ka angazhuar të gjitha njësitet relevante policore, duke përfshirë edhe menaxhmentin e policisë, që të dalë në vend të ngjarjes dhe t'i përgjigjet rastit", ka thënë ai, duke shtuar se janë angazhuar të gjitha agjencitë kompetente që të dalin në vendin e ngjarjes, përfshirë ekipet mjekësore, mjekësia

ligjore, forenzika dhe të gjitha njësitet e tjera që duhen për ekzaminimin e vendit të ngjarjes. "Nga informatat që kemi deri tani bëhet fjalë për një vdekje të dyshimtë, vrasje dhe vetëvrasje, ku kanë humbur jetën tre persona, një i gjinisë mashkullore, i vitit të lindjes 1958, një grua e vitit të lindjes 1959 dhe një vajzë e vitit të lindjes 1991. Informacionet që i kemi siguruar, por që mbeten të vërtetohen nga ekzaminimet, bëhet fjalë që personi i dyshuar i gjinisë mashkullore të ketë vrarë gruan e tij, më pas renë e tij e dyshohet që më pas ka bërë vetëvrasje", është shprehur Kelani.



Liderët bëjnë thirrje që të ruhet ambienti në Kosovë



Me rastin e Ditës së Tokës, liderët e institucioneve të Kosovës kanë bërë thirrje për ndërgjegjësime dhe veprim për mbrojtje të ambientit. "Secili prej nesh duhet të përkujdeset që mjedisi të jetë sa më i pastër dhe me sa më shumë gjelbërim, si dhe ta kufizojmë përdorimin e produkteve që ndotin dhe dëmtojnë natyrën. Vetëm atëherë ne të gjithë do të jetojmë më shëndetshëm dhe do ta ruanim planetin tonë për gjeneratat e ardhshme!", ka thënë presidenti Hashim Thaçi

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 PRILL - Me aktivitete të ndryshme në Kosovë është shënuar të hënën Dita Ndërkombëtare e Tokës. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e Ditës së Tokës, ka thënë se secili prej nesh duhet të përkujdeset për një mjedis të pastër si dhe ta kufizojë përdorimin e produkteve që ndotin natyrën. "Dita e Tokës, 22 Prilli, i shërben tërë botës si alarm për rritjen e kujdesit dhe për një ndërgjegjësim kolektiv për rëndësinë e mjedisit ku jetojmë. Njerëzimi sot është një prej dëmtuesve më të mëdhenj të tokës, pyjeve, lumenjve dhe të gjitha resurseve të tjera, prandaj ne të gjithë duhet të reflektojmë dhe të jetojmë duke u përkuj-

desur për gjithçka që na rrethon. Shkenca ka grumbulluar mjaft fakte që tregojnë se dy dekadat e ardhshme do të jenë vendimtare për fatin e planetit tonë. Secili prej nesh duhet të përkujdeset që mjedisi të jetë sa më i pastër dhe me sa më shumë gjelbërim, si dhe ta kufizojmë përdorimin e produkteve që ndotin dhe dëmtojnë natyrën. Vetëm atëherë ne të gjithë do të jetojmë më shëndetshëm dhe do ta ruanim planetin tonë për gjeneratat e ardhshme!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Veseli mbjell një fidan për Ditën e Tokës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në Ditën e Tokës ka mbjellë një fidan, duke u bërë kështu pjesë e fushatës "Mbille një pemë". Kryeparlamentari ka

zgjedhur që pishën ta mbjellë në Kovragë të Istogut, duke thënë se ky është "vendi i njerëzve punëtorë dhe me natyrë të

jashtëzakonshme". Veseli ka sfiduar në këtë fushatë futbollistët e Kombëtares së Kosovës, Fadil Demakun dhe ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili. "Në Ditën e Tokës kam vendosur të bëhem pjesë e fushatës për mbjelljen e një fidani, për t'i sensibilizuar kështu të gjithë qytetarët që të mbjellin sa më shumë fidanë për një ambient më të bukur në vendin tonë. Me këtë rast kam sfiduar që të bashkohen në këtë fushatë të gjithë futbollistët e kombëtares së Kosovës, Fadil Demakun dhe ministrin Uran Ismaili", ka deklaruar Veseli.

Haradinaj: Na duhet ndërgjegjësim e veprim për mbrojtje të ambientit

Me rastin e Ditës së Tokës, kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë thirrje që të ruhet ambienti. "Përgjegjësia jonë karshi natyrës dhe ambientit ku jetojmë duhet të shfaqet çdo ditë. Sot kur shënojmë Ditën e Tokës, më shumë se kurrë, na duhet ndërgjegjësim e veprim për mbrojtje të ambientit. Ta ruajmë bukurinë e Kosovës", ka shkruar

Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ambasadori Kosnett: Dita e Tokës, mundësi e mirë për vetëdijësim

Me rastin e Ditës së Tokës, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se kjo ditë është një mundësi e mirë për ta ngritur vetëdijen për problemet mjedisore me të cilat ballafaqohemi si shoqëri. Po ashtu, ai ka thënë se Dita e Tokës është mundësi e mirë për të festuar për përparimin që është arritur për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit gjatë dekadave të fundit. "Gëzuar Ditën e Tokës! Kjo ditë është një mundësi e mirë për ta ngritur vetëdijen për problemet mjedisore dhe për të festuar për progresin që kemi bërë për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit gjatë dekadave të fundit. Çfarë do të bëni ju për Ditën e Tokës? Tregoni planet tuaj nëpërmjet komenteve, fotografive dhe videove të shkurtër", ka shkruar Kosnett në llogarinë e Ambasadës së ShBA-së në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Azem Rexhaj

Shkrirja e KPMM-së në Shërbimin Gje

Anëtari i Bordit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Azem Rexhaj, i cili ka qenë edhe drejtor i këtij institucioni, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shkrirja e KPMM-së në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës do t'i dekurajojnë investitorët e huaj për sektorin mineral. Ai ka bërë me dije se janë në përgatitje të një dokumenti përmes të cilit do ta arsyetojnë domosdoshmërinë dhe rëndësinë e KPMM-së në nivelin e agjencisë së pavarur. Rexhaj ka thënë se këtë dokument do t'ia përcjellin qeverisë dhe do të jepen arsye pse nuk duhet të dëmtohet ky sektor aq i rëndësishëm



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 PRILL -

"Epoka e re": Z. Rexhaj, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive të pavarura ka paraparë që KPMM-ja të shkrihet në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, ndërkohë që ju po e kundërshtoni. Pse?

Rexhaj: Draftligji për Miniera dhe Minerale, i cili pritet të miratohet në lexim të dytë, ka paraparë avancim të sektorit mineral dhe kompetencave të KPMM-së, e jo të ndodhë e kundërta siç është paraparë me Projektligjin për racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive të pavarura. Bëhet fjalë për një draft që është duke e punuar Ministria e Administratës Publike në bashkëpunim me konsulentat e tjera që, veç të tjerash, ka paraparë që KPMM-ja të shkrihet në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës (ShGjK). Ne e kemi kundërshtuar, pasi hartuesi i këtij draftligji s'ka qenë fare i informuar për sektorin e minierave. Duket se ideja e tyre ka buruar nga ajo se KPMM-ja konsiderohet se ka kompetenca ekzekutive pasi lëshon licenca, por kjo nuk qëndron për faktin se licenca lëshon edhe BQK-ja dhe rregullatorët e tjerë. Në debatin publik që kishim, përveç KPMM-së, kjo ide nuk u

mbështet as nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës dhe as nga Ministria për Zhvillim Ekonomik. Prandaj presim të rishikohet ky projektligj.

"Epoka e re": Nëse ndodh një shkrirje e tillë, çfarë pasojash do të sjellë?

Rexhaj: Nëse KPMM-ja do të shkrihet në këtë institucion dëmi do të jetë i madh si për institucionin në fjalë, po ashtu edhe për kompanitë që janë aktive dhe ato që pretendojnë të investojnë, sepse do të humbë vazhdimësia e punës. Nëse KPMM-ja shkrihet në kuadër të ShGjK-së jo vetëm se do të shkatërrohet KPMM-ja, por edhe SHGjK-ja, pasi natyra e punëve të këtyre institucioneve është e ndryshme dhe paraqet konflikt interesi që të jenë në një kulm. Shërbimet Gjeologjike në botë, ashtu si në Kosovë, më shumë kanë qëllime shkencore. Prej themelimit të KPMM-së në vitin 2005 nuk ka ndryshuar struktura profesionale dhe vazhdimisht është avancuar. Unë isha drejtor i parë shqiptar në vitin 2007 dhe, përkundër që ka pasur transferim të kompetencave nga ndërkombehtarët, asnjë nga profesionistët nuk është ndërruar. Kemi vazhduar punën duke qenë ndër institucionet më kredibile dhe të vlerësuara nga vendorët dhe ndërkombehtarët. KPMM-ja në kuadër të stafit ka tetë doktorë shkence dhe 45 magjistra, pra kemi një staf të përgatitur

Po i vjen fundi kartëmonedhës 500 eurosh


PRISHTINË, 22 PRILL - Bankat qendrore të Gjermanisë dhe Austrisë kartëmonedhën prej 500 eurosh do ta lëshojnë vetëm deri këtë të premte (26 prill). Megjithatë, kjo nuk e ka nritur kërkesën e bankave për këso kartëmonedha. Pjesa tjetër e 17 bankave qendrore të

vendeve brenda eurozonës rrallë kanë parë kartëmonedha rozë që kanë ndaluar të prodhohen në fund të janarit. "Bankat qendrore në Gjermani dhe Austri deri tani kanë lëshuar më shumë kartëmonedha prej 500 eurosh në qarkullim. Për këtë edhe është vendosur që ato të

ndalohen për qarkullim. Për shkak se një sipërmarrje e madhe logjistike të gjitha bankënotat prej 500 eurosh do të zëvendësohen me nga 100 euro", ka thënë presidenti i Bankës Qendrore të Gjermanisë, Johaness Berman, për "Frankfurter Allgemeine Zeitung".



ologjik dekurajon investitorët e huaj



me standardet më të larta. KPMM-ja është themeluar si agjenci e pavarur dhe, nëse kalojmë në kuadër të ShGJK-së, nga topniveli do të zbesim në pesë nivele më ulët. Kjo do të jetë vështirë e kuptueshme edhe për investitorët e huaj. Është planifikuar që të përgatisim një dokument në mënyrë që ta arsyetojmë domosdoshmërinë dhe rëndësinë e të qëndruarit në nivelin e agjencisë së pavarur. Këtë dokument do ta dërgojmë në qeveri dhe MAP. Besoj se pasi t'i marrim informatat do ta kuptojnë se ky sektor është mjaft i rëndësishëm dhe nuk është sektor për t'u eksperimentuar më të. Përfundimisht nuk është në interes të askujt që një sektor kaq i rëndësishëm të dëmtohet.

"Epoka e re": Shkrija e KPMM-së, a mund të përkthehet në presion politik?

Rexhaj: Jo, pasi ne jemi në përfundim të mandatit dhe nëse ky ligj do të kalonte, kjo nuk parashihet të ndodhë brenda mandatit tonë. Qëllimi ynë është të mbrohet KPMM-ja. Ne po përpqemi për të mirën e institucionit dhe sektorit minerar. Sa iu përket pozitave administrative dhe profesionale, nëse ndodh një shkrije e tillë, atëherë mund të rrezikohen disa nga ato pasi do të dyfishohen.

"Epoka e re": Pse po prolongohet Ligji për Miniera dhe Minerale?

Rexhaj: Thënë të drejtën, nuk e di. Si anëtar i bordit nuk kam të drejtë të përzihem në çështje politike. E tëra që mund të them është se ligji e avancon sektorin minerar dhe ofron lehtësi për të bërit biznes në Kosovë, pasi vetë forma e ndryshimit të ligjit është derivat i dëgjimeve që janë bërë me të gjitha kompanitë, ku pas marrjes së opinioneve të tyre është formuar një grup punues nga Kuvendi i Kosovës me përfaqësues nga të gjithë aktorët ku kanë arritur për të përgatitur një draft për avancim të mëtutjeshëm.

"Epoka e re": Sa ka interesim për marrje të licencave nga investitorët e huaj për nëntokën e Kosovës?

Rexhaj: Interesimi është i

madh, por këtë interesim e zbehin disa mospërputhje ligjore. Kemi investitorë që ka hulumtuar që dhjetë vjet dhe ka përgatitur projektin e fizibilitetit që nuk i del pozitiv, pasi kemi një udhëzim administrativ në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, respektivisht të Agjencisë Pyjore, ku parashihet që kontrata t'u jepet vetëm për pesë vjet maksimumi, me sipërfaqe prej pesë hektarësh. Kjo e kufizon interesimin e tyre. Pasi të kalojë Ligji për Miniera dhe Minerale do të eliminohen këto mospërputhje, pasi është paraparë që të gjitha institucionet e tjera të obligohen që pëlqimet dhe kontratat e tyre t'i lëshojnë për sipërfaqe dhe afat në përputhje me licencën e aprovuar nga KPMM-ja. Prandaj, besoj se do të ketë interesim më të madh për investime. Një pengesë e tillë ka bërë që një kompani kandezo-australiane që disa vite nuk po mund ta vazhdojë punën për shkak të këtyre kufizimeve. Ne duhet t'i sigurojmë investitorët sa i përket kohës dhe sipërfaqes së shfrytëzimit. Për projekte milionëshe llogaritet edhe financimi i bankave. Llogariteni nëse u thonë bankave që kanë licencë vetëm për pesë vjet dhe vetëm për pesë hektarë, çfarë pasqyre mund t'u japin. Kemi interesim për investime nga kompani angleze, kanadeze, turke, polake dhe zvicerane. Gjithashtu, ka interesim edhe nga kompani nga Shqipëria dhe nga Kosova, të cilat janë aksionare. Interesimi i tyre është kryesisht për hulumtime të mineraleve metalike.

"Epoka e re": Për çfarë lloj licencash ka më së shumti kërkesa?

Rexhaj: Momentalisht më së shumti ka për guri gëlqeror nga gurthyesit pasi kërkesat në treg janë më të mëdha. Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave në mënyrë të vazhdueshme e ka rritur kërkesën. Edhe përkundër që KPMM-ja konsideron se janë lëshuar mjaftueshëm licenca për gurë gëlqerorë, por kur kompanitë sjellin të gjithë dokumentacionin dhe nëse i plotësojnë kërkesat e parapara me ligje, atëherë duhet t'ua japim licencat.

"Epoka e re": Sa është numri i licencave që keni lëshuar nga janari deri më tani? Dhe sa janë të hyrat për periudhën e njëjtë? **Rexhaj:** Nga janari deri më tani kemi lëshuar 21 licenca në hulumtim, 12 në shfrytëzim dhe 27 leje për aktivitetet të veçanta, kurse nga themelimi kemi lëshuar 863 licenca për hulumtim, 683 licenca për shfrytëzim dhe 655 leje për aktivitetet të veçanta. Kurse të hyrat për tremujorin e parë të këtij viti janë 7.245,312.63 euro e në periudhën e njëjtë të vitit 2018 ishin 6,163,709.5. Pra, kemi një rritje të të hyrave prej 1.081.603.06 milionë eurosh.

"Epoka e re": E sa iu përket licencave për pjesën veriore?

Rexhaj: Të gjithë i marrin licencat te ne, por ka kompani të papërgjegjshme si në veri dhe jug. Bile më shumë ka në jug se në veri që operojnë ilegalisht. Nuk përjashtohet mundësia se sa i përket industrisë minerale ka të palicencuara në veri, por në raste kur ne i inspektojmë, ua lëshojmë urdhëresat për ndërprerje të punës, ua lëshojmë gjobat dhe lënda përcillet në prokurori. Sa iu përket kompanive për hulumtim për minerale metalike në pjesën veriore, të gjitha janë të licencuara. Kemi kompani angleze, kanadeze, turke që kanë marrë licenca për hulumtimin e mineraleve metalike në të gjitha pjesët e Kosovës. Nëse flasim për "Trepçën" si në pjesën veriore, po ashtu edhe në atë jugore janë të pajisura me licenca të shfrytëzimit.

"Epoka e re": E paguajnë rentën minerare?

Rexhaj: Pjesa veriore ka paguar disa vjet, ndërsa minierat në pjesën jugore nuk kanë paguar asnjëherë. Pra, e gjithë "Trepça" ka mbi 12 milionë euro borxhe ndaj KPMM-së. E kanë për obligim të paguajnë por, marrë parasysh që për "Trepçën" licencat janë të lëshuara me një vendim të qeverisë, në të cilën thuhet se "Trepça" dhe KEK-u janë ndërmarrje me interes publik, atëherë u janë lëshuar licenca për interes publik. Kjo licencë lëshohet për afat dyvjeçar. Tani u kemi kërkuar të gjitha njësitë të "Trepçës" që t'i rinovojnë kërkesat e tyre konform statutit të ri.

Gjermanët shpenzuan 8 miliardë euro për birra vitin e kaluar

Berlin, 22 prill - Gjermanët shpenzuan mesatarisht 100 euro për kokë banori vitin e kaluar duke blerë birra apo pije me përmbajtje të birrës. Shifrat dolën nga një studim i tregut që bëri kompania "Nielsen". Sipas

saj, në vitin 2018 në Gjermani u shitën rreth 6.1 miliardë litra birrë, 2.9 për qind më shumë se në vitin paraprak. Qarkullimi u rrit për 7 për qind, përkatësisht në 8 miliardë euro, pasi pothuajse të gjitha brendet

e njohura të birrës i rritën çmimet. Sipas studiuesve të tregut, birrat klasike, si "Pilsner", u ballafaquan me konkurrencë në rritje, ndërsa birrat joalkoolike u bënë gjithnjë e më popullore.



Deçani përkujton sot dëshmorët e Sllupit dhe Hereqit

DEÇANI, 22 PRILL (ER) - Sot (e martë) në Komunën e Deçanit do të përkujtohen dëshmorët e Dukagjinit të cilët kanë rënë heroikisht 21 vjet më parë. Sipas njoftimit të media të komunës, në orën 11:00 do të

bëhen homazhe në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në fshatin Sllup dhe në orën 12:00 do të bëhen

homazhe në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në fshatin Hereq.

homazhe në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në fshatin Hereq.



Mbillen fidanë në 'Lagjen 028' në Fushë-Kosovë

FUSHË KOSOVË, 22 PRILL (ER) - Dhjetëra fidanë janë mbjellë në "Lagjen 028" në Fushë-Kosovë nga vullnetarët e "Let's Do It". Fidanët e mbjellë ishin dhuratë e rrjetit "Kosovo CRS", të cilët, ndër të tjera, iu bashkuan aksionit në të cilin kontribuoi edhe komuniteti që jeton aty. Nga një deponi e madhe e mbeturinave, e njëjta hapësirë publike tani u shndërrua në hapësirë të gjelbër, e cila mund të shfrytëzohet nga i gjithë komuniteti që jeton në atë lagje. Këtij aktiviteti i parapriu një aksion disaditor pastrimi në këtë lagje, i cili nisi në Ditën Ndërkombëtare të Komunitetit Rom. Nga aty u larguan dhjetëra kamionë me bërlllok nga Kompania "Pastrimi". Mbeturinat e larguara u pranuan pa pagesë nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në



Kosovë.

Ky aktivitet disaditor pati për

qëllim pastrimin e hapësirave publike në një lagje të banuar si

dhe ngritjen e vetëdijes së komunitetit për rëndësinë e

mirëmbajtjes së hapësirave publike afër të cilave jetojnë.

"Let's Do It" sërisht bëri thirrje që këto hapësira të mirëmbahen nga të gjithë dhe assesit të mos lejohet që ato të rikthehen në gjendjen e mëparshme. Po ashtu, "Let's Do It" kërkon përgjegjësi dhe punë më të madhe edhe nga komuna e Fushë-Kosovës për mirëmbajtjen e këtyre lagjeve ku jetojnë komunitetet pakicë.

Edhe aktiviteti i sotëm në Fushë-Kosovë ishte pjesë e aktiviteteve që po organizohen nga "Let's Do It" në kuadër të Javës së Tokës.

Javën e Tokës, "Let's Do It" e ka filluar në Komunën e Skenderajt më 19 prill, ku u organizua një aksion pastrimi si dhe u mbollën dhjetëra fidanë. Aktivitetet e Javës së Tokës do të përmbyllen më 27 prill në fshatin Drenoc të Komunës së Deçanit.

Latifi, Hochle dhe Durguti diskutuan për fuqizimin e rinisë

RAHOVEC, 22 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim përfaqësuesit e dy organizatave joqeveritare me të cilët ka biseduar për fuqizimin e rolit të rinisë. "Sot, bashkë me drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport, Bjondina

Kleqka, pritëm në takim të përzemërt përfaqësuesit e ShL-Gjermani dhe ShL - Kosova. Me Patrik Hochle, drejtor i ShL-Gjermani dhe Enis Durguti, drejtor i ShL-Kosova, diskutuam për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve

komunale dhe organizatës ShL - Kosova dhe për planet tona të përbashkëta për fuqizimin e rinisë. I falënderova për angazhimin dhe kontributin, njëherësh urova ShL - Kosova për 10-vjetorin e themelimit si OJQ vendore", ka thënë Latifi pas takimit.



Gjini mbjellë fidanë në varrezat e martirëve në Çabrat

GJAKOVË, 22 PRILL (ER) - Komuna e Gjakovës, Ditën Ndërkombëtare të Tokës ua ka kushtuar të gjithë atyre që kanë dhënë jetën për çlirimin e vendit dhe atyre që besuan se Kosova mund të bëhet shtet. Në nderim të të rënëve të kësaj komune, kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, të hënën ka mbjellë fidanë në varrezat e martirëve në Çabrat. "Për nder

të të gjithë dëshmorëve, martirëve dhe të zhdukurve të komunës sonë, kryetari i komunës, Ardian Gjini, bashkë edhe me familjarët e të rënëve, sot kanë mbjellë fidanë në varrezat e martirëve në Çabrat. Mbjelljet e fidanëve do të zhvillohen nëpër të gjitha rajonet e Komunës së Gjakovës nga dita e sotme deri më 5 qershor 2019", ka njoftuar komuna e Gjakovës.

Komuna e Shtimes, aksion për pastrimin e qytetit

SHTIME, 22 PRILL (ER) - Aksioni i iniciuar nga Qendra Rinore në Shtime, në bashkëpunim me Qendrën për Edukim, Inovacion dhe Zhvillim Profesional "Akademia" dhe Organizatën Leadership Development Association 'Albania - Kosova', të hënën, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Tokës,

kanë ndërmarrë një aksion për pastrimin e hapësirës nga parku deri te Qendra Rinore e kësaj komune. Pjesë e këtij aksioni ishte edhe nënkryetari i komunës së Shtimes, Rahman Jakupi, drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS), Lumni Amrush, zyrtarë policorë, pjesëtarë të

shoqërisë civile dhe qytetarë. Aksioni ka pasur për qëllim pastrimin e qytetit, por edhe sensibilizimin qytetar. Në fund të këtij aksioni, nënkryetari Jakupi, drejtori Amrush dhe të pranishëm të tjerë kanë mbjellë pemë në afërsi të Shtëpisë së Kulturës për nder të Ditës së Tokës.



21 vjet nga rënia e kolosit të UÇK-së, Veli Nocaj

ERALD SELCA

Zona Operative e Dukagjinit ishte bastion lufte dhe urë lidhëse me zonat e tjera. Pas rënies së komandantit legjendar Adem Jasharit dhe betejës së Glogjanit më 24 mars 1998 shumë të rinj e të reja, burra dhe gra, iu bashkuan radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Një prej tyre ishte edhe Veli Adem Nocaj, lindur më 29.10.1969 e rënë më 23.4.1998.

Veli Nocaj lindi në fshatin Dujakë, Komuna e Gjakovës. Mësimet e para i mori në shkollën fillore të Skivjanit, ndërsa ato të mesme në Gjakovë. Është nip i Haxhi Alisë nga Juniku, të cilin regjimi pesëdhjetëvjeçar serb, pas shumë torturave, me

pretekst të kërkimit të armëve në dimrin e ashpër të vitit 1956, e mbyti në pus të vet. Kjo ngjarje atë ditë e sot mbahet mend në rrafsh të Dukagjinit si makabre. Prindërit, Adem e Nuriye Nocaj, kishin pesë fëmijë: tri vajza e dy djem. Veliu ishte i pesti me radhë. Meqë prindërit i punonin në Gjermani, Veliu si kryfamiljar merrej me bujqësi, duke mos dashur të bjerë në sy të forcave të sigurimit serb, ngaqë tashmë ishte inkuadruar në radhët e UÇK-së. Ishte i martuar dhe ka lënë pesë fëmijë: dy djem dhe tri vajza. Shërbimin ushtarak e kishte kryer në qytetin e Tito Velesit në Maqedoni.

Në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u rendit qysh në ditët e para të paraqitjes së saj, përkatësisht më 23 mars të vitit

1998. Bashkëpunoi me Njësitin e Zonës Operative të Dukagjinit, Shtabi në Glogjan. Ka marrë pjesë në aksionin për furnizim me armë, me ç'rast vritet në pritën e 23 prillit të vitit 1998 në malet e Koshares bashkë me 18 dëshmorët nga Hereçi e Sllupi, si dhe me bashkëfshatarin Blerim Jonuzaj. Trupi i dëshmorit është varrosur në vendlindje dhe prehet këto ditë të Kosovës së lirë për të cilën luftoi sypatrembur si dragua shqiptarie.

Për Veliun janë recituar poezi, kënduar këngë, do të shkruhen romane dhe do të bëhen filma dokumentarë. Gjithashtu, do të kujtohet përjetësisht madhështia e tij dhe nami si një nga ushtarët e parë të UÇK-së. Veli Nocaj i takon pavdekësisë, Shqipërisë, bashkimit dhe përjetësisë.



Disa gra të kthyera nga Siria po hetohen për pjesëmarrje në grupe terroriste

PRISHTINË, 22 PRILL - Policia dhe Prokuroria e Kosovës kanë filluar intervistimin e disa grave që janë kthyer të shtunën në mëngjes nga Siria, me dyshimin se ishin pjesëmarrëse në grupe terroriste. Të shtunën në mëngjes autoritetet e Kosovës, të ndihmuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë kthyer 110 persona nga zonat e luftës në Siri, 74 fëmijë, 32 gra dhe 4 persona të rritur që dyshohet se kanë qenë luftëtarë.

Avokatja Fehmije Gashi Bytyqi ka ardhur në Qendrën për Mbrojtjen e të Huajve në fshatin Vranidoll afër Prishtinës, për të mbrojtur një grua e cila dyshohet se ka marrë pjesë në një organizatë terroriste në Siri dhe që burri i saj ende po qëndron në zonën e luftës në Siri. "Policia e Kosovës përmes Odës së Avokatëve më kanë ftuar sipas detyrës zyrtare ta mbroj një grua e cila dyshohet se ka marrë pjesë në grupet terroriste në Siri. Zonja të cilën e mbro-

jta ishte mjaftë shëndetlig ishte nënë e katër fëmijëve. Më tutje, çka vepron Prokuroria Speciale e Kosovës nuk e di ngaqë është një sfidë edhe për vetë institucionet e Kosovës sepse tash këto, përveç që janë të dyshuara, ato, në anën tjetër, janë edhe prindër, për shembull e mbrojtura ime ishte nënë e katër fëmijëve", ka thënë avokatja Gashi-Bytyqi.

Të gjithë të kthyerit po u nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore dhe ende nuk dihet kur do të lirohen. Nga personat e kthyer janë edhe katër militantë të cilët aktualisht janë në paraburgim si të dyshuar për pjesëmarrje në organizata terroriste.

Naile Arifi nga Prishtina erdhi në qendër me familjen e saj për ta vizituar gruan dhe pesë fëmijët e vëllait të saj i cili ka vdekur në zonat e luftës në Siri para tre vjetësh e gjysmë. Në një bisedë për Radion Evropa e Lirë, ajo tha se nuk i ka parë familjarët e saj

për pesë vjet e gjysmë. "Ne këtu kemi ardhur t'i shohim fëmijët e vëllait dhe gruan e tij. I takuam, elhamdulillah! Mirë qenkan, mirë i kanë pritur. I falënderoj edhe këta që i kanë pritur mirë. Që pesë vjet e gjysmë nuk i kemi parë. Gjendja e tyre është mirë, edhe pse një fëmijë i vëllait e kishte thyer këmbën, por mirë janë këta të tjerët", ka thënë Arifi. Takimi i Nailes me pesë fëmijët dhe gruan e vëllait të saj zgjati rreth 10 minuta.

Nailja është vetëm një nga shumë anëtarë familjarë që vijnë t'oi vizitojnë të afërmit e tyre që po qëndrojnë në këtë qendër. Vizitat e tyre zakonisht zgjasin vetëm disa minuta. Sipas Policisë së Kosovës, në Siri ende janë rreth 30 luftëtarë, 49 gra dhe tetë fëmijë të cilët janë me shtetësi të Kosovës. Që nga viti 2012 rreth 400 njerëz nga Kosova i janë bashkuar të ashtuquajturit Shteti Islamik.

'Let's Do It' vendos shporta për mbeturina në Dobërçan, MMPH-ja premtim investim 550 mijë euro

Gjilan, 22 prill - Organizata "Let's Do It Kosova" ka vendosur tri shporta për mbeturina në fshatin Dobërçan të Kmunës së Gjilanit.

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka premtuar një investim prej 550 mijë eurosh në fshatin Dobërçan, ku do të rregullohet rrjeti kryesor dhe dytësor të kanalizimit. "Rëndësia e Ditës së Tokës dhe Planetit tonë mund të kuptohet drejt në rast se, përveç aksioneve të pastrimit e vendeve të degraduara nga mbeturinat, vizitojmë vende që ditën e tokës e kanë për çdo ditë, një rast i tillë është edhe në fshatin Dobërçan, një nga fshatrat më të mirëmbajtura në

Kosovë, me ç'rast sot në ditën e tokës jemi këtu për t'i përgëzuar banorët e Dobërçanit për vullnetin dhe angazhimin e tyre për një mjedis të pastër, në bazë të kësaj edhe Ministria e Mjedisit në kuadër të politikave të veta, siç e kam thënë edhe më herët, synon që t'i mbështesë lokalitetet të cilat kujdesen për ambientin në të cilin jetojnë. Sot e rikonfirmojmë këtu se do të fillojmë një investim prej 550 mijë eurove në fshatin Dobërçan për rregullimin e rrjetit kryesor dhe dytësor të kanalizimit dhe për rregullimin e shtratit të lumit që kalon përmes këtij fshati. Kjo është meritë e qytetarëve të Dobërçanit", ka thënë Matoshi.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



Sulmet në Shri Lankë dyshohet se lidhen me një rrjet ndërkombëtar

SHRI-LANKË, 22 PRILL - Vala e sulmeve që vrau 290 njerëz të dielën në Shri Lankë u krye me mbështetjen e një rrjeti ndërkombëtar, thanë zyrtarët. Qeveria fajësoi grupin lokal xhihadist, Jamath, edhe pse askush nuk e mori ende përgjegjësinë. Sulmet vetëvrasëse në kisha dhe hotele lanë edhe rreth 500 persona të plagosur. Policia arrestoi 24 njerëz në lidhje me to, ndërsa Zyra e presidentit të Shri Lankës shpalli

gjendje të jashtëzakonshme kombëtare. Gjendja e tillë i jep policisë dhe ushtrisë kompetenca të gjera për të ndaluar dhe marrë në pyetje njerëz. Tri kisha në Negombo, Baticaloa dhe Kolombo ishin në shënjestër të sulmeve, ashtu si edhe hotelet Shangri-La, Kingsbury dhe Cinnamon Grand në kryeqytetin Kolombo. Zyrtarët thanë se të gjitha sulmet u kryen nga bombardues

vetëvrasës. Zëdhënësi i Qeverisë, Rajitha Senaratne, tha se autoritetet besojnë se sulmuesit kanë pasur mbështetje ndërkombëtare. "Ne nuk besojmë se këto sulme janë kryer nga një grup njerëzish që kanë qenë të mbyllur në këtë vend", tha Senaratne. "Është një rrjet ndërkombëtar, pa të cilin këto sulme nuk kanë mundur të ndodhin", shtoi ai.



Pas raportit Mueller, vëmendja kthehet te Kongresi

Demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve janë të vendosur që të sigurojnë një kopje të plotë, të paredaktuar të dokumentit, i cili nuk gjeti bashkëpunim të qëllimshëm mes rrethit të afërt të presidentit Donald Trump dhe Ruisë, por që as pohon, as mohon që presidenti pengoi drejtësinë

UASHINGTON, 22 PRILL - Uashingtoni vazhdon të mbetet i përqendruar te hapat që mund të ndërmarë Kongresi, pasi raporti i redaktuar i Prokurorit të Posaçëm Robert Mueller për hetimin e Ruisë u bë publik javën e kaluar. Demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve janë të vendosur që të sigurojnë një kopje të plotë, të paredaktuar të dokumentit, i cili nuk gjeti bashkëpunim të qëllimshëm mes rrethit të afërt të presidentit Donald Trump dhe Ruisë, por që as pohon, as mohon që presidenti pengoi drejtësinë. Raporti i shumëpritur sinjalizon se presidenti Trump nuk përballet me sfida ligjore nga Departamenti i Drejtësisë për çështje të lidhura me Rusinë. Po për sa i takon Kongresit që ka kompetenca të hetojë dhe të fillojë procesin e shkarkimit të mundshëm? Republikanët që kontrollojnë Senatin, duan ta mbyllin këtë kapitull. Demokratët, që kontrollojnë Dhomën e Përfaqësuesve janë të ndarë për hapat e mëtejshëm. "Ne nuk mund të jemi një Amerikë që thotë se është në rregull që një president i ShBA-

së të përpiqet të bllokojë hetime ndaj një sulmi të huaj ndaj vendit tonë, apo hetime për gabimet e vetë presidentit. Prandaj unë i kam bërë thirrje Dhomës së Përfaqësuesve të fillojë procesin e shkarkimit", thotë senatorja demokrate Elizabeth Warren, kandidate demokrate për presidente. Por kreu i shumicës demokrate në Dhomën e Përfaqësuesve, Steny Hoyer shprehu dyshim se ishte ide e mirë që të ndiqej rruga e procesit të shkarkimit, duke vënë në dukje se populli amerikan do ta thotë fjalën e fundit në zgjedhjet presidenciale të vitit të ardhshëm. Presidenti Trump nuk ka ndenjur në heshtje. Ai shkruante në Twitter: "Demokratët e së majtës radikale nuk duan të bëjnë ligje për të mirën e popullit, por vetëm të hetojnë dhe të shpërdorojnë kohën. Kjo po i kushton rëndë vendit tonë dhe do t'u kushtojë shumë demokratëve në vitin 2020!" "Ajo që duhet të vendosim ne si demokratë është se ç'është më e mira për vendin? A është më mirë që të ndiqet procesi i kërkesës së shkarkimit, sepse



përndryshe përçohet mesazhi se kjo sjellje mund të tolerohet? Apo është në interes të vendit të mos fillojmë një proces shkarkimi që ne e dimë se nuk do të ishte i suksesshëm në Senat? Është një pyetje tepër e vështirë", thotë ligjvënësi demokrat Adam Schiff. Shtëpia e Bardhë këmbëngul se presidenti është provuar i pafajshëm.

"Nuk pati bashkëpunim të fshehtë. Nuk pati konspiracion mes fushatës së presidentit Trump dhe Kremlinit për të dëmtuar dhe përhapur keqinformim për zgjedhjet tona. Presidenti nuk do të shkojë në burg. Ai do të jetë në Shtëpinë e Bardhë edhe për 5 vjet e gjysmë. Pse? Sepse nuk u gjet asnjë krim", thotë këshilltarja e presidentit Kellyanne Conway,

Raporti i Prokurorit Mueller detajon përpjekjet ruse për të keqinformuar dhe keqorientuar votuesit amerikanë dhe për të dëmtuar fushatën e kandidates demokrate të vitit 2016, Hillary Clinton. Rusia ka mohuar të ketë ndërhyrë ndërsa Shtëpia e Bardhë fajëson administratën e ish-presidentit Obama, që nuk arriti t'i frenojë veprimtaritë dashakeqe të Moskës.

Zelenski fiton zgjedhjet presidenciale në Ukrainë

KIEV, 22 PRILL - Presidenti aktual i Ukrainës, Petro Poroshenko pranoi humbjen, duke i njohur fitoren rivalit të tij në zgjedhje Volodimir Zelenski. Të dielën u zhvillua balotazhi mes presidentit aktual, Petro Poroshenko dhe humoristit Volodimir Zelenski, i cili luan rolin e një presidenti në një serial komik televiziv. 41-vjeçi Zelenski, megjithëse pa përvojë politike, kryesonte në anketa gjatë javëve të fundit.

Fushata e tij mori hov pas një filmi të vakët, ndërkohë që votuesit po shprehen gjithnjë e më të zhgënjyer nga korrupsioni, problemet ekonomike dhe konflikti në lindje të vendit. Presidenti Poroshenko u përpoq të mobilizonte bazën e tij me një tubim në Sheshin "Pavarësia" në qendër të Kievit të premten në darkë, disa orë para një debati televiziv me rivalin e tij. Poroshenko ka theksuar disa herë se rivali i tij do të shfrytëzo-

hej nga presidenti rus Vladimir Putin nëse zgjidhet në krye të vendit. Ai u përpoq gjithashtu të nxiste frikën se me zgjedhjen e Zelenskit do të dëmtoheshin shanset e Ukrainës për integrim në Bashkimin Evropian. Zelenski shmangu intervistat për median, por vazhdoi deri në fund të fushatës shfaqjet komike në të gjithë vendin. Ai i mëshonte mesazhit për forcimin e lidhjeve me BE-në dhe NATO-n.



ORGANIZATA PATRIOTIKE ILEGALE 'PARTIA E LUFTËS E KOSOVËS' (2)



**Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA**

Në Komunën e Mitrovicës, në muajin shtator 1981, me iniciativën e Rrahim Ramës është formuar grupi ilegal, që më vonë të lidhet me ndonjë organizatë më të madhe. Raif Rama është zgjedhur kryetar i grupit, Raif Qela sekretar, kurse Agim Gosalci dhe Agron Hamiti janë bërë anëtarë të grupit. Në muajin tetor të vitit 1983, nëpërmjet patriotit Mehë Uka janë vënë në kontakt me Kadri Osmanin, i cili i ka njoftuar për ekzistimin dhe veprimtarinë e organizatës "Lëvizja e Republikës Socialiste të Shqiptarëve në Jugosllavi" dhe për përpjekjet e "Lëvizjes..." që të shndërrohej në "Front antirevizionist". Njëherësh, i ka njoftuar se Raif Qela është pranuar si anëtar në radhët e "Lëvizjes..." dhe i janë caktuar detyrat konkrete, që në anën e Mitrovicës të formonte "Treshen" ilegale, së cilës do t'i bashkëngitej edhe Mehë Uka sapo të kthehej nga shërbimi ushtarak. Kadri Osmani i ka treguar se edhe Rrahman Rama është zgjedhur një ndër tre përgjegjësit kryesorë për Universitetin e Prishtinës në "Shtabin Operativ Shkencor", me gradën ushtarake të majorit dhe se do të organizohet një atentat kundër dy personave të SPB-së të Gjilanit, nga shkaku se i kanë torturuar jashtë mase të burgosurit politikë.

Në fillim të korrikut 1983 Remzi Bunjaku bëhet anëtar i "Lëvizjes", së bashku me Ajet Dulin. Nëpërmjet Kadri Osmanit furnizohen me literaturë të ndaluar e më vonë njoftohen se kjo organizatë përkrah kërkesën që Kosova të fitojë statusin e Republikës. Materialin ilegal e shfrytëzonin anëtarët e rinj, siç ishin: Ajet Duli, Rrahim Rama si dhe Xhevdet Thaqi.

Në takimet e mëvonshme kanë vendosur të formojnë "Komitetin Revolucionar Ushtarak të Kosovës", me propozim të udhëheqësisë:

1. Adem Demaçi, që gjendej në vuajtje të dënimit, u emërua komandant i Forcave të Përgjithshme Ushtarake me gradën "Marshall".
2. Xhafer Shatri, i cili ndodhej në emigracion në Zvicër është emëruar zëvendëssekretar i përgjithshëm i "Komitetit".
3. Rexhep Mala, është emëruar

zëvendëskomandant i forcave të armatosura.

4. Kadri Osmani, është emëruar sekretar ekzekutiv i partisë dhe ministër i punëve të brendshme.

5. Hasan Mala, që gjendej në emigracion, është emëruar shef i kabinetit.

6. Kadri Abdullahu, që gjendej në emigracion, është emëruar shef i diplomacisë për jashtë, kurse

7. Nuhi Berisha është caktuar për kryetar të rinisë së "Komitetit të Kosovës".

Me këtë rast janë caktuar edhe gradat e të tjerëve. Kështu, përveç Adem Demaçit, të cilit i është caktuar grada "Marshall", për të tjerët janë ndarë gradat "major", kurse gradat më të ulëta janë paraparë për "shtabet operative, qarkore e rajonale" etj. Me këtë rast është paraparë edhe formimi i organizatës së "Rinisë Revolucionare të Kosovës". Anëtarët e organizatës kanë paraparë që të dalin edhe jashtë shtetit, bile të shkojnë edhe në Kombet e Bashkuara, e mundësisht edhe si delegacion të shkojnë në Shqipëri. Për t'i sendërtuar këto ide, u vendos që dy anëtarë nga organizata të shkojnë në perëndim që të takohen me Xhafer Shatrin, Hasan Malën dhe Kadri Abdullahun dhe t'i njoftojnë për formimin e "Lëvizjes së Frontit Antirevizionist, pararojës së sajë, Partisë së Luftës të Kosovës" dhe formimin e "Komitetit Revolucionar Ushtarak të Kosovës". Platformë e saj është bashkimi i të gjitha viseve të banuara me shqiptarë në RSFJ dhe pastaj pason bashkimi i tyre me shtetin amë - Shqipërinë.

Vlen për t'u cekur se edhe në këtë periudhë, pas vitit 1981, organizatat ilegale mund të kenë emra të ndryshëm, por programet dhe platformat e tyre përafërsisht ishin të njëjta dhe qëllimi parësor i tyre ishte që Kosova të fitonte statusin e republikës dhe në një të ardhme jo të largët të bëhej bashkimi i saj me shtetin amë - Shqipërinë. Ndodh edhe kjo që shumë anëtarë të ilegales u përkisnin shumë organizatave ilegale. Rasti më konkret është edhe i organizatës së "Partisë së Luftës së Kosovës", e cila bashkëpunon ngushtë me "Lëvizjen e Republikës Socialiste të Shqiptarëve në Jugosllavi", por që anëtarët e saj inkuadrohen edhe në organizata të tjera, njëherësh edhe anëtarë të organizatave të tjera futen në këtë organizatë, siç është rasti i Adem Demaçit, i Kadri Osmanit etj. Fundja, ishte me rëndësi se të gjitha organizatat kishin vetëm një qëllim suprem, çlirimin e Kosovës nga okupuesi serbosllav.

Pas një pune të suksesshme dhe aktiviteti të dendur politik ilegal, pas një përcjelljeje të gjatë të organeve të sigurimit, disa nga

veprimtarët e organizatës zbulohen. Kështu, më 29 qershor të vitit 1984 Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët: Ymer Osaj, kryetar, Sllobodan Zhivkoviç dhe gjyqtarët porotë: Azem Emini, Dojçin Maksimoviç e Iljaz Aliu, anëtarë, në praninë e të akuzuarve, mbrojtësve të tyre, përfaqësuesit të akuzës publike - zëvendësprokurori publik i qarkut në Prishtinë, Njazi Burgu - Deva, shpall aktgjykimin me numër P. nr. 108/84, duke i akuzuar këta atdhetarë:

1. Kadri Osmani (1937), Makreshi i Ulët (Gjilan), arsimtar - 15 vjet burgim
2. Enver Topalli (1959), Greme (Ferizaj), student - 14 vjet burgim
3. Abdullah Rustolli (1943), Prugovc (Prishtinë), i papunë - 10 vjet burgim
4. Raif Qela, (1963), Reshan (Mitrovicë), student - 12 vjet burgim
5. Rrahim Rama, (1963), Klinë e Ulët, student - 5 vjet burgim
6. Remzi Bunjaku (1956), Strezoc (Kamenicë), punëtor - 6 vjet burgim
7. Ajet Duli, (1954), Svirçë (Medvegjë), arsimtar - 7 vjet burgim
8. Mehë Uka (1962), Bajgorë (Mitrovicë), student - 7 vjet burgim
9. Negjmedin Gërguri (1964), Bellaqevc i Madh, student - 5 vjet burgim
10. Mahmut Ibrahim, (1962), Bellogogjide (Strugë), student - 1 vit burgim
11. Ibush Vishi, (1958), Dubravë (Kaçanik), student - 9 vjet burgim
12. Behxhet Imishti, (1958), Dubravë (Kaçanik), student - 10 vjet burgim
13. Ramë Buja, (1958), Bujan (Lipjan), student - 8 vjet burgim
14. Agim Vishi, (1960), Shkup, sh. e mesme - 8 vjet burgim.

Në vazhdim po paraqesim vetëm disa reagime të anëtarëve që i japin para trupit gjykues: Kadri

Osmani: Të gjitha këto janë trillime të kombinuara në hetuesinë e zhvilluar në SPB dhe nën presion

Enver Topalli: Pasi që ka hyrë në sallën e gjykimit, ka ngritur dorën e djathtë dhe me zë të lartë ka bërë titur: "Vdekje fashizmit, më vonë do ta kuptosh se ç'do të thotë kjo, do të vijë koha kur do të kuptosh". Në hetuesi ndaj meje janë përdorur mjetet e shtrëngimit, andaj kam nënshkruar nën presion. Konsideronte se në Kosovë janë shkelur të drejtat e njeriut, sidomos të drejtat e shqiptarëve të cilët janë të shkelur, të torturuar, se Kosova është e shfrytëzuar nga të tjerët, ju jeni duke na gjykuar, por do të përgjigjeni para popullit e ai do t'ju japë përgjigjen me top.

Abdullah Rustolli: Të gjitha këto janë shpifje dhe montime. Në hetuesi deklaraten e kam dhënë i detyruar nga torturat.

Raif Qela: Të gjitha veprimet paraprake i kam pohuar nën tortura dhe në këtë mënyrë kam qenë i detyruar të pohoj çdo gjë që është kërkuar nga unë.

Rrahman Rama: Të gjitha akuzat janë absurde dhe paraqesin ofendim e fyerje për të.

Remzi Bunjaku: Çdo gjë e dhënë është nën presion dhe cilësimi juridik i veprës penale nuk është i drejtë.

Mehë Uka: Asnjë veprim i tij nuk është armiqësor dhe është plotësisht i pafajshëm dhe i dënues pa kurrfarë baze ligjore. Nënshkrimi i procesverbalit, i përpiluar nga SHSSH-ja, është i falsifikuar.

Ibush Vishi: Pa bazë i vihet në barrë vepra penale nga akuza e improvizuar, se përdorimi i dhunës ka ndikuar që të bëjë vetë shpifje dhe se në përgjithësi veprimet e veta i ka pranuar se ka lexuar dhe ka shpërndarë literaturë të ndaluar dhe se është solidarizuar me përmbajtjen e tyre.

Ramë Buja: Pranon se ka lexuar literaturë të ndaluar, njëherësh

pranon se personave të caktuar ua ka shpërndarë "Traktin kundër tradhtisë", se veprimet e tjera nga akuza i ka pohuar në hetuesi, i detyruar nga torturimet çnjerëzore e barbare të punëtorëve të sigurimit dhe se do të ishte nder i madh sikur të ishte bërë anëtar i ndonjë organizatë. Behxhet Imishti: nuk ka dashur të japë mbrojtjen e vet, duke thënë se nuk dëshiron të flasë, sepse kjo gjykatë është gjykatë revizioniste, gjykatë antipopullore.

Organizata Ilegale Patriotike "Partia e Luftës së Kosovës", kryesisht veprimi në trevën e Komunës së Prishtinës, të Podujevës dhe në disa vende të tjera të Kosovës. Ajo konsideronte se LRSJH-ja dhe organizatat e tjera ilegale duhet të inkuadrohen në organizatën unike të quajtur "Fronti Antirevizionist", pararojë e së cilës do të ishte organizata "Partia e Luftës së Kosovës". Në këtë organizatë kontribut të çmuar dha edhe ish-i burgosuri politik, Murteza Nura, i cili, pas vuajtjes së dënimit, përsëri u inkuadrua në aktivitetin patriotik. Gjatë veprimtarisë së vet bashkëpunoi me Muharrem Rugovën, me Rustem Zeqirin, me Sahit Metajen dhe me patriotët të tjerë të organizatës ilegale në trevën e Komunës së Gjakovës. Gjatë vitit 1978, ai e përqendron aktivitetin në konsolidimin me anëtarë të rinj, në mënyrë të bindshme shkoqit bazat ideologjike e programore të veprimit dhe mund të konsiderohet një ndër ideologët kryesorë, që hartoi dhe siguroi literaturë të konsiderueshme me përmbajtje antishtetërore, të cilën ua shpërndau anëtarëve të organizatës. Intensivisht merrte pjesë në shqyrtimin e detyrave të mëtejme të organizatës, inicion dhe flet në të mirë të veprimtarisë patriotike në të gjitha fushat e jetës. Në gusht të vitit 1981, u arrestua dhe u dënua me 9 vjet burg të rëndë si pjesëtar i grupit ilegal patriotik. (Fund)



E rrallë

Mrekullia në Notre Dame, 180 mijë bletë i shpëtojnë zjarrit

Dhjetëra mijëra bletë të mbajtura në koshere në çatinë e Notre Dames kanë mbijetuar nga zjarri shkatërrues që depërtoi në katedrale. "180 000 bletët që jetonin në tri koshere në kulmin e çatisë së katedrales janë zbuluar gjallë", ka thënë Nicolas Geant, bletari i monumentit.



FOTO E DITES



Në këtë fotografi shihet një skulpturë gjatë Kampionatit Evropian të Gdhendjes së Gurit në Dunbar të Skocisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Marinari i verbër, udhëtim pa ndalesë në Paqësor

Një marinar i verbër japonez ka vendosur rekordin teksa bëhet i pari person që nuk shikon që përfundon një udhëtim pa ndalesë në Oqeanin Paqësor. Mitsuhiro Iwamoto, që e nisi udhëtimin nga Kalifornia, mbërriti në portin e Fukushimës me barkën 12 metra të gjatë mëngjesin e së shtunës, pas rreth dy muajsh. 52-veçari, banues në San Diego, e



nisi udhëtimin më 24 shkurt, i shoqëruar nga Doug Smith, i cili e ndihmoi atë duke i dhënë informacione në lidhje me drejtimin e erës.

BARSOLETA E DITËS



Një burrë dhe grua shkojnë në operë. Pas një gjysmë ore që kishte filluar shfaqja, gruaja i thotë burrit: - Shiko atë burrin në krahun tënd si e paska zënë gjumi.
Burri: - Për të më treguar budallallëqe më zgjon nga gjumi ti mua?




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00 "HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00) "THE KID WHO WOULD BE KING"

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00 "CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00 "U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Po ju vijnë në mend çaste që keni shumë


dëshirë t'i riktheheni përsëri. Kujtime të bukura që thjesht po ju shoqërojnë gjatë ditës.



DEMI

Keni rezultate të shkëlqyera në një

projekt që vijnë si pasojë e bashkëpunimit shumë të mirë që keni me kolegët tuaj.



BINJAKËT

Kujtimet e ëmbla po ju lezetojnë

ditën sot. Jeni të përkundur nga një ndjenjë kënaqësie që nuk e kuptoni se nga vjen.



GAFORRJA

Sot dëshironi të qëndroni të

qetë në ambientin tuaj që ju pëlqen aq shumë. Një ditë jo me ndonjë ngjarje të veçantë për t'u mbajtur mend.



LUANI

Duhet ta mbani nën fre krenarinë

tuaj dhe ambicien e tepruar sepse në të shkuarën keni bërë gabime që ju kanë kushtuar shtrenjtë.



VIRGJËRËSHA

I keni pasur çastet tuaja të

lavdisë gjatë paradites së sotme dhe për këtë jeni shumë krenar. Mbrëmja paraqitet e qetë.



PESHORJA

Sot një ditë e mirë për takime pune ose

konkurse shkolle. Fati është në anën tuaj dhe çdo gjë do të përfundojë në favorin tuaj.



AKREPI

Sot do të vendosni të kaloni një ditë me

miqtë sepse ju duhet mendimi i tyre për një vendim të rëndësishëm që do të merrni.



SHIGJETARI

Jeni disi të pakënaqur me disa situata

që po ndodhin rreth jush. Do të kërkoni të gjeni fajtorin, por nuk do të mundni dot.



BRICJAPI

Do t'ju vlerësojnë për aftësitë

tuaja në punë sot dhe meritat do të jenë si morale ashtu edhe financiare.



UJORI

Sot çdo gjë ju çon larg banales

dhe vulgaritetit. Do të ndjeheni shumë të lirë.



PESHQIT

Sot gjatë gjithë ditës do të mendoni

vetëm për çështje punë dhe financiare. Duhet të mendoni edhe për çështjet e zemrës ndonjëherë.


Pas ndarjes, burri mund t'ia marrë Adele gjysmën e pasurisë

Bashkëshorti i Adeles, Simon Konecki, mund ta marrë gjysmën e pasurisë së saj prej 150 milionë funtash pasi çifti u nda fshehurazi vitin e kaluar. Dokumentet tregojnë se Adele shiti shtëpinë e tyre tre milionë funte në vitin e kaluar dhe transferoi një pronë LA në emrin e Simonit, shkruan "TheSun". Adele ende ka një rezidencë prej 7.3 milionë funtash në Beverly Hills, LA, dhe një shtëpi banimi prej 7.4 milionë funtash në Kensington, në



qendër të Londrës, gjithashtu ka një banesë 1.5 milion funte në jugperëndim të Londrës.

Zoe Kravitz duket e mrekullueshme rrugëve të Nju Jork



Aktorja e famshme, Zoe Kravitz, është fotografuar nga paparacët teksa shëtitej rrugëve të Nju Jorkut. Aktorja dukej

shumë bukur. Ajo pati të veshur xhinse të shkurtra dhe një pallto ngjyrë vjollce. Kravitz çdoherë komentohet për stilin e saj unik.



Rihanna pozon për 'Vogue'

Ylli botëror i muzikës, Rihanna, ka zënë numrin e ri të revistës 'Vogue Australia'. Këngëtarja duket në super formë në këtë fotosesion, ani pse me

disa veshje të thjeshta, Riri duket shumë impresionuese. Ka kohë që nuk ka sjellë ndonjë projekt muzikor, por ka paralajmëruar se po punon në albumin e ri.

Beyonce e Netflix nënshkruajnë marrëveshje 60 milionëshe



Këngëtarja e famshme botërore Beyonce nuk po ndalet së prodhuari krijime artistike. Ajo tash ka nënshkruar marrëveshje për tri projekte me Netflix që asaj do t'i sjellin përfitime prej 60 milionë dollarësh. Fillimisht është

dokumentari i Coachellas, "Homecoming", që u lansua më 17 prill në platformën e njohur. Edhe HBO kishte mundësinë e nënshkrimit me Beyoncën, por Netflix arriti që ta bindë këngëtarën falë ofertës më të mirë.

Historia e Marthës, gruas së Frojdit

“Vogëlushja ime e dashur, e dija që, vetëm kur të ishe larg, do të ndërgjegjësohesha për lumturinë time të pamasë, dhe po aq, edhe për përmasën e saktë të asaj që më mungon...”, kështu I shkruante një mbrëmjeje bashkëshortes së tij Zigmund Frojd. Psikologu I mëndjes njerëzore kishte një raport të ndërlikuar me gruan e tij Martha Bernays. Ata u takuan në prill të vitit 1882 dhe vetëm pas pesë vitesh fejesë u martuan, më 14 shtator 1886 në Hamburg. Por duket se kohë e artë mes tyre kanë qënë vetëm vitet e fejesës, pasi martesat ashtu si të gjitha martesat ndryshon gjithcka. Sipas biografit të Frojdit Ernest Jones “letrat e dashurisë që ata I kanë dërguar njëri tjetrit janë

ndër më të bukurat, e do të mbeten gjithnjë në botën e letërkëmbimeve”. Janë mbi 900 letra që ai ia ka nisur në këtë periudhë Marthës. “E dashura ime, ditët bëhen të padurueshme kur jam larg teje. Po mendoja se ku mund të jesh tani, dhe në e ndjen padurimin e zemrës sime”, I shkruante Frojd në një tjetër letër.

Pas martesë ata patën gjashtë fëmijë. Martha ishte një grua elegante dhe tërheqëse dhe tepër e kulturuar. Martesa e tyre do të kishte shpesh krisje, për shkak të raportit që Frojdi krijoi me motrën e saj Minna Bernays, e cila jetoi gjithë jetën me ta. Martha e dite për këtë lidhje të fshehtë, por nuk I pengoi të jetonin intimitetin e tyre.



Elena një shkrimtare e dhunuar



Ka një mit rreth martesës së poetit meksikan Octavio Paz, nobelist i vitit 1990, dhe shkrimtares së shquar meksikane Elena Garro. Kjo martesë ka ngelur si një shembull kulmor i traditës patriarkale kundër lirisë së gruas, i forcës kundër dobësisë, i jetës publike kundër jetës shtëpiake, i kujtesës kundër harresës. Thënë më qart: Paz kundër Garro. O. Paz dhe E. Garro u njohën në vitin 1935 dhe pas dy vjetësh, kur ajo sapo kishte mbushur 20 vjeç, u martuan.

Për këtë martesë vetë Elena Garro flet gjithë dhimbje te libri i saj «Kujtime nga Spanja» (1992). Ajo tregon aty për zhgënjime të njëpasnjëshme dhe për mbyllje në “një syrgjyn rregullash strikte dhe të ashpra”. Në këtë libër E. Garro tregon se atë mëngjes të 1937, ndërkohë që ajo do të shkonte të jepte një provim të latinishtes u martua me O. Paz, pasi ky dhe miqtë e tij e bindën ta linte provimin dhe të shkonin drejt te një gjykatës, ku zyrtarizuan martesën. Pas kësaj martesë të

nxituar ajo nuk do t'i kthehej më jetës studentore dhe do ta kishte tejet të vështirë t'i kushtojë prirjes dhe talentit të saj ndaj letërsisë. Qysh nga ky moment çdo veprim të saj do ta drejtonte i shoqi. Ajo duhet të jetonte për atë dhe për veprën e tij, gjë që e bëri armike të përjetshme të tij. E zhgënjyer dhe e penduar nga kjo martesë, E. Garro, në vitin 1947, dy herë tentoi të vraste veten. Dhe njëmbëdhjetë vjet më pas, divorci midis tyre u bë i pashmangshëm.

Shkrimtarja Patricia Rosas Lopategui, autore e librit “Vrasja e Elena Garros”, thotë: Ajo është një feministe që jetoi nën tiraninë jo vetëm të Oktavio Pasit, por edhe të një klike intelektualësh të cilët e konsideronin vetëm si grua apo ish-grua të dikujt. Kurse shkrimtarja tjetër meksikane, Elena Poniatowska, thotë për Garron: E dashur dhe e urryer, e adhurar dhe e mohuar, udhëton e vetmuar dhe jo pak herë e çorientuar nga një ekzistencë në të cilën nuk e njohu as të drejtën, as lumtur-

inë. Me gjithë konfliktet bashkëshortore dhe mangësitë e intimitetit të domosdoshëm në punën krijuese, Garro gjatë asaj periudhe të vështirë realizoi prodhimtarinë më të madhe letrare të saj. Vepra e saj letrare përqendrohet kryesisht në dramaturgjë, ku vihet në pah mënjanimi i gruas, liria e femrës, sidomos liria politike dhe konflikti i saj në rolet e ndryshme të shoqërisë meksikane. Ngjashmëria midis shkrimeve dhe jetës së saj bëjnë të quhet si një heroinë e vetë veprës së saj.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82


Klubi i Karatesë 'Prishtina', i suksesshëm edhe në turneun 'Shpresat e Kosovës 2019'

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Klubi i Karatesë "Prishtina" ka vazhduar me suksese, këtë herë në turneun kombëtar "Shpresat e Kosovës 2019". Garat u mbajtën në palestrën "13 Qersori" në Therandë, nën organizimin

e Federatës së Karatesë së Kosovës. Pjesëmarrëse ishin 34 klube me mbi 280 pjesëmarrës, të cilat treguan shkathtësitë e tyre. Normalisht që në mesin e tyre ishin edhe karateistët e Klubit "Prishtina" të cilët kor-

rën suksese. Sportistët e Klubit "Prishtina" që u treguan të suksesshëm në këtë garë janë: Antoneta Budakova, Era Gërbeshi, Riga Dresha, Shpata Llallosi dhe Rina Haxhiu.

Benzema hyn në historinë e Realit

Madrid, 22 prill - Karim Benzema është bërë lojtari i parë i Real Madridit që ka shënuar tetë gola radhazi pa asnjë ndalesë. 31-vjeçari ka shënuar tetë golat e fundit të "Los Blancos", diçka që ndodh për herë të parë në historinë 117-vjeçare të klubit.

Edhe legjenda e vërtetë e Merengues, Cristiano Ronaldo, golashënuesi kryesor i të bardhëve gjatë gjithë historisë, nuk ishte në gjendje ta arinte këtë rekord. Kjo seri golash të Benzemas filloi katër javë më



parë, kur shënoi në minutën e fundit të fitores 3-2 kundër Huescas. Francezi shënoi pastaj në humbjen 2-1 ndaj Valencias, para dopietës në fitoren 2-1 ndaj Eibarit.

Benzema shënoi edhe në barazimin 1-1 kundër Leganes të hënën, por e bëri të vetën "skenën" mbrëmë, duke realizuar një "hat-trick" kundër Atletico Bilbaos. Benzema e ka gjetur 30 herë rrugën e rrjetës në 50 ndeshje të luajtura këtë sezon, duke qenë zëvendësuesi më dinjitoz i Cristiano Ronaldos në "Santiago Bernabeu", pasi portugezi shkoi te Juventusit verën e vitit të kaluar.

SHKURT

Chelsea shfaq interesim për Coutinhon

Chelsea është duke shikuar mundësitë që ta transferojë Philippe Coutinho nga Barcelona gjatë afatit kalimtar të verës. Sipas "Calciomercato", braziliani shikohet si zëvendësimi i Eden Hazardit në rast të largimit nga Stamford Bridge, i cili së fundi ka qenë i lidhur me një kalim te Real Madridi. Ish-ylli i Liverpoolit nuk është i kënaqur me minutat te klubi nga Camp Nou dhe kështu ai është duke menduar largimin. Kujtojmë se Coutinho iu bashkua Barcelonës nga Redsi në janar të vitit 2018 për 120 milionë euro, por ka dështuar ta impresionojë trajnerin Ernesto Valverde, nën urdhrat e të cilit ka bërë vetëm 35 ndeshje në 15 muaj.



Reali vendos çmimin për kartonin e fantazistit Isco

Sipas së përditshmes spanjolle "Don Balon", Reali i Madridit ka fiksuar çmimin e shitjes së fantazistit Isco, që është 60 milionë euro. Me rikthimin e Zidanes, Isco ka zhvilluar ndeshje të mira, por sërish kjo nuk e shpëton nga "operacioni fshesa" që do të zhvillohet në klubin madrilen këtë verë. Për fantazistin spanjoll interesohen klube të shumta si Juventusit, Manchester City, Arsenali dhe Chelsea.



Phelan synon pozitën e drejtorit sportiv në Manchester United


Mike Phelan, i cili është asistent në Manchester United, po synon pozitën e drejtorit sportiv në këtë klub. Ai edhe më parë ka qenë drejtor sportiv i skuadrës Coast Mariners dhe tani beson se është njeriu i duhur për ta marrë të njëjtën pozitë te Djajtë e Kuq. Bashkëpunëtorët e tij, Michael Carrick dhe Kieran McKenna, janë pranë nënshkrimit të kontratave të reja. Ndërsa Mike Phelan është duke kërkuar avancim në këtë klub.



E ardhmja e Thierry Henrys në ShBA, si trajner

Ish-ylli i Arsenalit si dhe ish-trajneri i Monakos, 41-vjeçari Thierry Henry, po shikon Shtetet e Bashkuara të Amerikës si të ardhmen e karrierës së tij. Ai është në bisedime për t'u bërë drejtuesi i ri i New York Red Bulls në MLS.



	Autor: GAZMEND MORINA		QË BESON VERBËRISHT NË DOGMËN FETARE	ZBËRTHIM I NJË ÇESHTJE	PIJE FRESKUESE E ATHËT (sh.shq.)	SOLISTJA ... BYTYQI	SPIUNIA E FAMSHME ... HARI	EPOKA E RE	NDESH	ANTON PASHKU	KOMANDANT I NJË ANUJEJE	SFOND SHKRONJASH	FAREFISI (bised.)
	LUTEM (fet)							HEROI ZEJNULLAHU					
	SHPIRTI (Lat.)							PANDJESI I PËRQESHUR					
	PËSHPËRIT FJALË MAGJIKE									PRAPA KRUIJA, APOLONIA			
	PËRGJIGJE NË TELEFON						AGIM TEJECI AZEM BEJTA			SHTET NË AMERIKË FALJE QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT			
	KËNGËTARJA ... TARNER							RROGA VJETORE E PAPËS ELIZA DUSHKU					SHKENCA QË STUDION METODAT DHE MJETET E HETIMIT E TË ZBULIMIT TË KRIMEVE
	AKTORJA E FAMSHME ITALIANE ROSSELLINI (shqip.)									"E" para dy "K" HYJNI E DASHURISË (mit. romake)			
MUZIKANTI AMERIKAN ... ROCK						RE E DENDUR TYMI SHUMË E GJATË						BASHKËT. UDHËHEQËSI I NJË PARTI POLITIKE	
EPOKA E RE	KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO	JONI ME NGARKESË NEGATIVE	NËNREPART USHTARAK I PËRBËRË PREJ DISA TOGASH	ENË PËR TË NXJERRË UJË NGA BUNARI (shq.) FUTBOLLIST PORTUGEZ	IGLI TARE	"A" në mes të dy "M" PJESE E FORTË E BUKËS (sh.shq.)		KORNIZË VËNIA E MINAVE			BRUS ... TATUAZH (bised.)		
QË SHPREHET ME PAK FJALË E NË MËNYRË TË PRERË							KAMION I VOGËL QË KA TË BËJË ME FSHATINË, FSHATARESKE			FJALË E DHËNË PËR DIÇKA KANAPE E GJERË DHE E GJATË			
PËRTËRITËS								RIDERS (shk.) MARK ANTONI			KËNGËTARJA ROZANA ... ZANORE		
PORT DETAR					SHTET NË EVROPË MJET UDHËTIMI E TRANSPORTI (shq.)					NGJYRË E FYTYRËS NOTË MUZIKORE			
KING OF PRUSSIA				PËRSËRITËS (gram.) PJESE E EPËRME E DHOMËS						ILUZIONISTI SHQIPTAR NADIR ... RENS ISTVUD			
MËRI, ZILI				REOMIR, TANTAL SHKRIMTARI HAZIRI (shq.)			AKTORI EGJIPTIAN SHARIF (shq.) LLOJ I LETËRSISË EPIKE				IRMA LIBOHOVA ROBERT REDFORD		
KULLË E XHAMISË						DIKTATUR RUS					RAVENA DUKAT		ZANORE BOSHT
JAM I DENJË TË NDEROHEM E VLEJ TË MË JEPET NJË ÇMIM A NJË SHPËRBLIM	FUTBOLLISTI KROAT KLASNIÇ PARIA E SHOQËRISË					EPOSI VEPRIMTARI I SHQUAR PETRO ... LUARASI		MJET PUNE (shq.)	REKUIZITË SPORTIVE (shq.)	NËPËR ARA, ARAVE PËREMËR VETOR			
BASHKË, TOK (bised.)			"ASHTU QOFTË" KALIBËR I TYTËS SË ARMËS			QË NXË NJË OKË (PËR ENËT) BËRTHAMOR							KASTRIOT TUSHA SPORT LUFTARAK
SHKRIMTARJA KADARE					I BËJ APEL ZANORE						KNOWLEDGE SYSTEMS INSTITUTE NJËSI PESHE PËR GURËT E ÇMUAR		
RITUAL				SHKRIMTARI ALIGIERI LËNDË MËSIMORE				PERIUDHË E GJATË DHE E RËNDËSISHME HISTORIKE VENDËS, RRËNJËS					BASHKËT. NDËRRIM I MALLIT
VENDLINDJA E ODISEUT					DY ZANORE ISLANDA		KALI I STËRVITUR MA JEP				KËNGËTARJA BAJRAMI ANNAPOLIS PERFORMANC E SAILING		
KRYEQYTETI I ESTONISË						HUQ, VES VARIOLË					BUJK BASHKËT.		TEDI ALVES
OSAKA		NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE ZANORE			SUPER MODELJA ADRIANA BASHKËT.				ARMË E FTOHTË PREJ ÇELIKU (sh.shq.) ONTARIO				
RILINDËSI ... VRETO				PIKTORI PABLO						EMBLEMA			



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. NR. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë shpallë këtë:

K O N K U R S

I. DEPARTAMENTI LIGJOR

1. Pozita: Zyrtar Ligjor - 1 (një vend pune)
Referenca: MD/DL/23-04-01-2019
Koeficienti: 7
I përgjigjet: Udhëheqësi i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit
Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Merr pjesë aktive në hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore nga fushë veprimtaria e Ministrisë;
- Sigurimi i pajtueshmërisë së projektligjeve dhe të akteve tjera nënligjore me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës;
- Kryerja e formatizimit të ligjit, të revidimeve gjuhësore dhe ligjore, si dhe përkujdesja që përmbajtja teknike e ligjit të jetë e saktë dhe identike në të dy gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze;
- Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara
- Kryen detyrat në fushën profesionale specifike me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme
- Përcjellja dhe menaxhimi i procedurave për hartimin dhe dorëzimin e projektligjeve në Qeveri;
- Bashkërendimi dhe ndërlidhja e punëve, sipas nevojës me zyrtarët e tjerë të Departamentit Ligjor dhe të Divizioneve;
- Kryen të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara nga udhëheqësi i divizionit apo udhëheqësi i Departamentit Ligjor.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

- Diploma universitare, Fakulteti Juridik;
- Minimumi dy (2) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e Legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të legjislacionit të aplikueshëm në fushat e përgjegjësisë së ministrisë;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (World, Excel, Power point, Access, internetit).
- Njohja e gjuhës shqipe apo serbe, e preferuar njohja e gjuhës angleze

Marrja dhe dorëzimi i Aplikacioneve: Ministria e Drejtësisë / Divizioni për Burimeve Njerëzore, Rruga « Ish-Ndërtesa e Rilindjes » kati i 8 (tetë), Zyra Nr. 803, Prishtinë, Kosovë;

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore në, tel: 038 / 213 870 ose 038 - 200 182 72, prej orës 08:00 - 16:00.

Konkursi ngel i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore, duke filluar nga data **23.04.2019** gjer më datën **07.05.2019**, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit intervistues.

“Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës”.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Na osnovu Zakona za Civilnu Sluzbu Republike Kosova L.BR. 03/L-149 i Uredbe Br. 02/2011 za Procedure Rekrutiranja u Civilnoj Sluzbi Republike Kosova, Ministarstvo Pravde (MP) objavljuje ovaj:

K O N K U R S

I. PRAVNI DEPARTAMENT

1. Pozicija: Pravni Sluzbenik - 1 (jedno radno mesto)
Referenca: MP/PD/23-04-01-2019
Koeficienti: 7
Odgovara: Rukovodioc Divizije za Izradu i Usklađivanje Zakonodavstva
Mesto: Priština

Zadaci i odgovornosti:

- Aktivno učestvuje u izradi zakona i podzakonskih akata iz delokruga rada Ministarstva;
- Osiguranje usklađenosti nacrt zakona i drugih pod zakonskih akata sa Ustavom i zakonodavstvom na snazi u Republici Kosova;
- Formatiranje nacrt zakona, jezičke i zakonske revizije, kao i osiguranje da tehnički sadržaj nacrt zakona bude tačan i identičan na oba službena jezika i na engleskom jeziku;
- Po zahtevu, obavlja specijalizovane zadatke iz određene stručne oblasti u skladu sa odgovarajućim zakonima, propisima, politikama i procedurama, unutar određenog vremenskog roka;
- Obavlja određene poslove u stručnoj oblasti sa razumnim stepenom nezavisnosti, pod nadzorom i povremenim uputstvima;
- Pracnje i upravljanje procedura za izradu i podnošenje nacrt zakona u Vladi;
- Koordiniranje i saradnja sa ostalim službenicima iz pravnog Departamanta i sa službenicima u Divizijama;
- Obavlja i druge poslove određene od strane šefa Divizije ili šefa Departamanta.

Uslovi, kvalifikacija, iskustvo, sposobnosti i licne karakteristike:

- Univerzitetska diploma: Pravni fakultet;
- Najmanje 2 (dve) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Poznavanje i iskustvo u izradu i usklađivanje zakonodavstva i drugih pravnih akata;
- Poznavanje primenljivog zakonodavstva u oblastima odgovornosti Ministarstva;
- Komunikacijske veštine u planiranju rada i timskog rukovodstva;
- Veštine za istraživanje, analiziranje, evaluaciju i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
- Sposobnost za ispunjenje zadataka i rad pod pritiskom;
- Kompjuterske veštine u primeni programa (Word, Excel, Power Point, Access, Internet);
- Poznavanje albanskog ili srpskog jezika, poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Prijem i predaja aplikacije: Ministarstvo Pravde/Divizija Ljudskih Resursa, Adresa Bivsa Zgrada „Rilindja“ Osmi (8) Sprat, Kancelarija Br. 803, Priština, Kosovo;

Za detaljnije informacije možete kontaktirati Kancelariju Divizije Ljudskih Resursa na Tel: 038 200 182 72, svakog radnog dana od 08:00 - 16:00 časova.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednom od dnevnih novina, pocevsi od **23.04.2019** do **07.05.2019**, koji se smatra kao posljednji dan zaključenja Konkursa.

Aplikacije poslate poštom, koje sadrže poštanski žig o slanju posljednjeg dana odnosno roka za aplikaciju, smatraće se blagovremenim i uzet će se na razmatranje, aplikacije koje stignu van ovog roka i one koje su nekompletne neće se uzeti na razmatranje

Uz aplikaciju bit ce prilozena kopija dokumenata o kvalifikaciji, radnom iskustvu, i druga potrebna dokumentacija koje zahteva radno mesto za koje se konkuriše.

Kandidati koji će biti izabrani za uži krug biće pozvani na intervju od strane osoblja pismeno ili putem telefona, i duzni su da sa sobom ponese originalne dokumente o kvalifikacijama i završnoj obuci, za verifikaciju od strane Personela.

„Civilna Sluzba Kosova služi svim stanovnicima Kosova, i pozdravlja Aplikacije žena i muškarca svih zajednica Kosovu“.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektor i Personelit



Nr. Ref. 225/19, datë 14.03.2019.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës, nenit 13 pika 1 e Statutit të QKUK-së, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit të Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës të datës 13.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M

Për Anulim të Konkursit publik,

- I. **Anulohet në tërësi** Konkursi publik nr. 181, datë 05.02.2019 për **Zyrtar i Lart i Mirëmbajtjes së Pajisjeve Mjekësore**, një pozitë në QKUK;
- II. Obligohet Sektor i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Përzgjedhës i caktuar sipas Vendimit nr. 181/2 datë 07.02.2019, me Rekomandimin nr. 181/4 datë 13.03.2019, njofton që ky konkurs të anulohet në tërësi për arsye se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm edhe pas vazhdimit të dytë ka qenë një kandidatë dhe në bazë të nenit 6 pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, komisioni kërkon anulimin e tij, të modifikohet më mirë dhe i njëjti të publikohet sa më parë që të jetë i mundur.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe kërkesës në fjalë, lejon anulimin e Konkursit publik dhe kërkon që i njëjti të publikohet konform ligjit në fuqi.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET

- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



HIDROENERGJI - Sh.p.k
Rr: Dëshmorët e Kombit Pn - Ferizaj Kosovë
www.hidroenergji.com, info@hidroenergji.com

NJOFTIM

Licencimi i Aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë në Kosovë

“Hidroenergji” SH.P.K. adresa Dëshmorët e Kombit, p.n. Ferizaj, përmes procedurës së Autorizimit për Ndërtim të Kapaciteteve të Reja, ka ndërtuar gjeneratorin e energjisë elektrike të quajtur **Hidrocentrali (HC) Lepenci 3** me kapacitet **9.98 MW në lokacionin Sllatinë, komuna e Kaçanikut, ANDAJ** në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj **NJOFTON** palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë. Aplikacioni për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Pas licencimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji, i licencuari mund të kryej aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me dispozitat e asaj licence, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh pune, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. “Dervish Rozhaja”, Nr. 12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: hrexhaj@ero-ks.org; Tel. 038247615/118.

Rr: Dëshmoret e Kombit, Pn, Ferizaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektor i Personelit



Nr. Ref. 225/19, data 14.03.2013.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, članom 13 tačka 1 Statuta UKCK, članom 6 tačka 5.1, Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Postupaka Konkursa u javnom sektoru, i Preporuka predsednik Komisije za izbor na dan 13.03.2019. godine, Generalni Direktor UBKSK-a izdao je sledeće:

O D L U K A

Za poništenje (anulira) javnog konkursa

- I. Ukinut u punom javnom konkursu br. 181, od 05.02.2019.godine za **Viši Službenik za Održavanje Medicinskih Oprema jedna pozicija u UKCK**;
- II. Sektor kadrova je obavezan da primeni ovu Odluku;
- III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o ž e n j e

Komisija za izbor dodeljena odlukom br. 181/2 od 07.02.2019, sa Preporukom br. 181/4 od 13.03.2019. Godine, izveštava da se ovo konkurs treba u potpunosti poništiti jer nema dovoljno kandidata čak i nakon što je drugi produžetak bilo samo jedan kandidat i na osnovu člana 6 tačka 5.1 Administrativnog Uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupka javnog konkursa, Komisija traži njeno poništenje, bolje modifikovana i objavljena što je prije moguće.

Shodno tome, Generalni Direktor UBKSK, prema nadležnostima, prema važećem zakonu i preporuke komisije, dozvoljava otkazivanje javnog konkursa i zahtijeva objavljivanje u skladu sa važećim zakonom.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI

- * Kancelarija za kadrove,
- * Informacioni medij.
- * Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Integrimit Evropian

Ministarstvo Evropske Integracije/ Ministry of European Integration

Ministria e Integrimit Evropian

VAZHDON AFATIN E KONKURSIT

Vazhdohet për 7 ditë kalendarike afati i konkursit të shpallur nga data 03/04/2019 deri më datë 17/04/2019, për pozitën e lirë:

Drejtor i Departamenti të BE-së - Numri i referencës: 07/2019 DDBE/MIE;

Afati i konkurrimit vazhdohet nga data 23.04.2019 deri më 29.04.2019 deri në orën 16.00.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga nëna Tereze p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në web-faqen <http://mci-ks.net/> Kërkesat për punësim dorëzohen në zyrën e personelit nr. N-909 kati X, ndërtesa e Qeverisë, ose përmes postës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038-200-27-006

Ministarstvo za Evropske Integracije

PRODUŽAVA ROK KONKURSA


Produžava se za 7 kalendarskih dana rok konkursa objavljenog od 03/04/2019 do 17/04/2019, za slobodnu poziciju:

Direktor Odeljenja za zakonodavstvo EU-a- broj referencije: 07/2019/-DDBE-/MIE

Produžava se rok za konkurisanje od 23.04.2019 do 29.04.2019 do 16.00 časova.


Zahtev za zapošlavanje i opis poslava mogu se dobiti na recepciji zgrade Vlade Republike Kosova (ulica Majka Tereza bb). Obrazac za apliciranje možete skinuti sa veb-sajta <http://mci-ks.net/> Zahtevi za zapošlavanje predaju se u kancelariji za ljudske resurse br. N-909 X sprat, Zgarda Vlade, ili poštom.

Dodatne informacije možete dobiti preko telefona : 038-200-27006



**TOP
PAKO**

 Komunikim **FALAS**

 Internet deri në **50Mbps**

 Televizion Digjital

Për vetëm 17euro

TOP PAKO, PËR TË GJITHË!

TOP Pakot përmbajnë të gjitha shërbimet e nevojshme të komunikimit për biznese të vogla por edhe për familje.

Prej vetëm 17.00€, **10 numra me komunikim FALAS**, PLUS:

- ∞ minuta drejt IPKO-së;
- ∞ SMS;
- Internet në mobil deri në 5GB;
- Televizion digjital dhe Internet deri në **50Mbps**;
- Telefoni Fikse me tarifa standarde;

Për më shumë informata, vizitoni dyqanin më të afërt të IPKO-së.

WWW.IPKO.COM

